# GAZETA SHQIPTARE

PR PRESTIGE Resort

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7887 E diel 19 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


BEER KORÇA
... edhe sot më e mira

Opinioni i Ditës

Nga ANDI BUSHATI



## Shfaqja e panevojshme e Ramës në "Opinion"

Kanjë kod të pashkruar të të gjithë mashtruesve profesionistë (përjashto këtu delirantët, të sëmurët apo mitomanët): mos e shpërdoro gënjeshtrën kur ...

Vijon në faqen 21

Opinioni i Ditës

Nga PËLLUMB KARAMETA



## Të talentuarit

Për ta flasim jo pak. I çmojmë nëpër biseda dhe dëshirojmë të kemi sa më shumë të tillë në shkencë, kulturë, ekonomi dhe udhëheqje. Po çfarë i dallon të talentuarit? ...

Vijon në faqen 22

LISTA E RE/ FAMILJET QE MARRIN TAPITE NE TIRANE DHE NE RRETHE

# LEGALIZIMET, PRONESIA E TOKES PER 2000 FAMILJE

Ndërtimet pa leje, kompensohen pronarët, si ndahen 230 milionë për 510 përfitues. Dokumentet që duhen dorëzuar, karta e identitetit dhe llogaria bankare



*(Në foto)* Zonë informale

Në faqet 8-9



Kryebashkiaku bisedonte me Avdylajt

## Përgjimet e dosjes '339', Vangjush Dako pyetet mbi 5 orë në prokurori, ja bisedat

Implikimi në bisedat me të fortët e Shijakut, dyshime për blerje votash në 2017

"Vol Vo 4", megaoperacioni i Policisë së Shtetit në kuadër të luftës ndaj krimit të organizuar, rezultoi të ishte vetëm maja e ajsbergut në atë ç'ka do të denoncohej ditët në vijim në media, ndërsa protagonist vijon të mbetet kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Arrestimi i Avdylajve në Shijak zbuloi atë ç'ka përflitej nën zë prej thuajse një viti nga opozita ...

Në faqen 5

MAXHORANCA

## Rama mbledh kandidatët e PS: Dialog, por nuk iki si kryeministër

Në faqen 3

ZGJEDHJE PARA KOHE

## Publikohet skandali i zëvendësit të tij, kancelari i Austrisë jep dorëheqjen

Në faqen 3

OPOZITA

## Basha në Londër: Zgjedhjet vendore, pas krijimit të qeverisë tranzitore

Në faqen 2

KANDIDATI PER KREUN

## Gjinushi: Akademia e Shkencave, mbaj përgjegjësi për merita e dështime

Në faqen 12

"MILOSAO"




## Papa me origjinë shqiptare Klementi XI dhe ikona e Shën Mërisë

Suplement

Zv.ministrja e Arsimit, Lori Haxhiu: Shkollat profesionale garantojnë sukses

## Shkolla Ekonomike, bashkëpunim me "Luarasin"

*Prof.dr Ethem Ruka: Çfarë mund t'u ofrojmë nxënësve tuaj*

NGA VOLTIZA DURO

Roli i arsimit profesional është vendimtar në ndërtimin e një shoqërie me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e kulturor. Mbi të gjitha, tregu i punës kërkon çdo ditë e më shumë persona të aftë në profesione



të ndryshme. Shkolla Teknike Ekonomike në Tiranë është një ndër shkollat profesionale që ofron mundësi të shumta zgjedhjesh për nxënësit. Në "Ditën e dyerve të hapura", zv.ministrja e Arsimit, Lori Haxhiu është rikthyer edhe njëherë ...

Në faqen 10

# KRIZA POLITIKE
## ZGJIDHJA

Kreu i PD: Taksat në rrugën Tiranë-Durrës dhe në Rrugën e Kombit nuk do të ekzistojnë

# Basha nga Londra: Zgjedhjet, pas krijimit të qeverisë transitore

*"Një qeveritar e blen kolltukun 15 mijë euro"*

Valentina Madani

Nga Parlamenti britanik, kryetari i opozitës, Lulzim Basha paralajmëroi se nuk do të ketë zgjedhje më 30 qershor pa u ndëshkuar politikanët që vodhën me krimin zgjedhjet e 2017! "Zgjedhjet e diktuara nga krimi janë rrënja e krizës, sepse kanë prodhuar një parlament të diktuar nga krimi dhe jo nga vota e shqiptarëve. Politikanët që janë kapur në bashkëpunim me krimin e organizuar për të vjedhur zgjedhjet e 2017-ës duhet të ndëshkohen dhe jo të promovohen. Pa shkëputur lidhjet e krimit me politikën, nuk mund të ketë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Largimi i qeverisë dhe kryeministrit të kapur në flagrancë duke bashkëpunuar me krimin për të shkatërruar procesin zgjedhor të 2017-ës dhe krijimi i një qeverie transitore janë mënyra e vetme për zgjidhjen politike të krizës", - theksoi z.Basha. Gjatë vizitës në Westminster, kreu i PD-së dhe delegacioni që e shoqëron zhvilluan një takim me kryesuesit e grupit parlamentar bipartizan për Shqipërinë në Parlamentin britanik, deputetët John Grogan (kryetar i grupit) dhe Martin Vickers (nënkryetar). Në këtë takim u diskutua gjerësisht për shkaqet e krizës politike në Shqipëri, për krizën kushtetuese, mungesën e Gjykatës Kushtetuese, mungesën e Gjykatës së Lartë, mungesën e një prokurorie të pavarur që nuk i mbyll, por i heton dosjet e krimit të lidhur me pushtetin. Delegacioni i përbërë edhe nga kryetari i PR, Fatmir Mediu, Aldo Bumçi dhe Xhemal Gjunkshi zhvilloi një takim në Dhomën e Lordëve me lordin Peter Bowness, zv.presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe njëherësh, anëtar i Dhomës se Lordëve në Parlamentin britanik. Gjatë vizitës në Londër, Basha u prit në Parlamentin e Britanisë nga kryetari i Komisionit të Sigurisë dhe Inteligjencës, Dominic Grieve. Gjatë takimit, Basha theksoi domosdoshmërinë për të forcuar shtetin ligjor dhe demokracinë në Shqipëri, si dhe për të qëndruar krah për krah aleatëve euroatlantikë. Ai tregoi vendosmërinë që bashkëpunimi midis dy vendeve në fushën e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit të jetë sa më i fuqishëm dhe sa më efikas. "Bashkëpunimi i ngushtë në luftë kundër krimit të organizuar dhe në veçanti trafikut të qenieve njerëzore e të narkotikëve do të ndihmojë në goditjen e kriminalitetit dhe në rikthimin e besimit", - tha kreu i opozitës. Basha shtoi se kjo do të shërbejë për të mos njollosur reputacionin e komunitetit shqiptar në Britani nga një pakicë e përfshirë në aktivitete kriminale. "Jemi të vendosur për të ndërtuar në Shqipëri institucione të forta ligjzbatuese, të pandikuara dhe të afta për të luftuar krimin e organizuar dhe narkotrafikun", nënvizoi Basha.

### TAKIMI

Kreu i PD-së, Lulzim Basha deklaroi se nuk do të lejojë vendosjen e taksës në rrugën Tiranë-Durrës dhe se me ardhjen në pushtet të kësaj force politike, do të anulojë edhe taksën për Rrugën e Kombit. Sipas Bashës, ato varfërojnë shqiptarët dhe heqja e tyre do të mundësojë që të ketë më shumë qarkullim. Kreu demokrat, Lulzim Basha, premtoi para shqiptarëve në Britaninë e Madhe se nuk do të lejojë që në rrugën Tiranë-Durrës të vendoset taksë. Nga Londra ku zhvilloi një takim me komunitetin shqiptar, Basha tha gjithashtu se në momentin që PD-ja do të vijë në pushtet, do të anulojë edhe taksën e vendosur në Rrugën e Kombit. Sipas Bashës, këto taksa janë të gabuara pasi varfërojnë akoma më shumë shqiptarët. "Mua m'u ngarkua detyrë ndërtimi i rrugës dhe më dhemb në zemër të shoh që diçka që u bë me lekët e shqiptarëve tani, u kërkojnë shqiptarëve të paguajnë 2-3 fish. Paguajnë edhe taksën e rrugës, edhe taksën e qarkullimit. Asnjëra prej tyre nuk do të ekzistojë kur PD të jetë në pushtet. Pse nuk do të ekzistojnë? Sepse të dyja varfërojnë shqiptarët. Duke i hequr këto të dyja, ne mundësojmë që të ketë më shumë qarkullim. Kjo është ndarja me thikë midis atyre që e kanë mendjen vetëm te taksat, vetëm te shtrëngimi, që është Shqipëria e frikës dhe Shqipërisë së lirisë", theksoi z.Basha. Ai denoncoi mungesën e investimeve për auditorët në fakultete, teksa thekson se paratë që duhet të ishin investuar aty, në fakt janë bërë rrush e kumbulla nga qeveria. Sipas Bashës, një qeveritar e blen kolltukun 15 mijë euro, ndërsa shton se qeveria duhet të rri para popullit dh ejo të marrë paratë e tij e t'i bëjë rrush e kumbulla.



Kreu i PD-së gjatë vizitës në Londër

**SALI BERISHA**

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje Edi Ramën se po ndëshkon shqiptarët me 140 milionë euro gjobë. Ai përmend rastin e televizionit "Agon Channel", duke thënë se Rama e mbylli atë me pretekste të ndryshme për gjoja pastrim parash, në një kohë që arsyeja e vërtetë është fakti që televizioni godiste fort propagandën e Ramës.

## "Përplasje, nëse tentohet rikthimi i monizmit"

## Përplasje në 30 qershor? Bardhi: Votime në Shqipëri nuk do të ketë

Sekretari i përgjithshëm i PD-së, Gazment Bardhi, konfirmoi vendimin e PD-së për të mos lejuar mbajtjen e zgjedhjeve më 30 qershor. I ftuar në emisionin "Kjo Javë", në "News 24", i pyetur se si do të mundësohet pengimi i zgjedhjeve dhe se a do të ketë përplasje, u përgjigj se për demokraci ka pasur përplasje për këdo që përpiqet të kthejë monizmin. "Zgjedhje më 30 qershor nuk do të ketë, votime në Shqipëri nuk do të ketë. Përgjegjësia jonë është të mos lejojmë zgjedhje farsë. Detyra jonë është të mbrojmë demokracinë dhe



t'i ofrojmë mundësinë shqiptarëve zgjedhje të lira dhe të ndershme. Për demokraci ka pasur përplasje për këdo që përpiqet të kthejë monizmin", theksoi z.Bardhi. Ai akuzoi se Shqipërinë po e destabilizon Rama, që sipas tij, është personi që me bandën e tij po çon Shqipërinë për në destabilizim. "Sa i takon dhunës të shfaqur me pamje, polici që goditi do të marrë përgjigjen e merituar personale dhe ligjore. Përgjigjen e merituar nuk do të marrë vetëm ai, por kushdo që gjuan mbi protestuesit e pafajshëm. Policia është sjellë në mënyrë kriminale, aprofesionale dhe të paligjshme. Kjo qeveri bën krim, edhe me atë se helmon gjysmën e Tiranës. Qytetarët janë helmuar me gaz lotsjellës nga Policia e Shtetit, është përdorur uji me presion dhe është tentuar gjatë gjithë kohës që të pengohet tubimi. Nuk është përdorur as molotov dhe asnjë akt dhune", u shpreh Gazmend Bardhi.



SHKURT

## Sulmi, policia merr në mbrojtje Borchardt bashkë me familjen

Pas sulmit në banesën e tij, Policia e Shtetit ka marrë në mbrojtje ambasadorin e OSBE-së, Bernd Borchardt. Pak ditë pas parullës "Borchardt shame on you" (Borchardt turp për ju) poshtë pallatit ku banon diplomati, që dënoi ashpër dhunën në protestën e datës 11 maj të opozitës, policia ka vendosur që ta marrë në mbrojtje bashkë me familjen e tij. Efektivët e policisë janë stacionuar 24 orë poshtë hyrjes së pallatit. Jo vetëm Policia e shtetit, por edhe ajo private monitoron me kamera të gjitha hyrjet dhe daljet në pallatin ku banon ambasadori. Ndërkohë që deri tani janë shoqëruar dy vajza, të cilat u morën në pyetje (njëra ish-kandidate e LSI-së për deputete) në lidhje me parullën që u shkrua kundër ambasadorit dhe më pas u liruan. Petrit Vasili i doli në mbrojtje duke thënë se vajza ka të drejtën dhe është e lirë të shprehë mendimin e saj.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Kreu i qeverisë: Zgjedhjet nuk do të shtyhen, kush i prek, digjet nga SHBA e BE

# Kriza, Rama: Dialog me Bashën, por nuk iki nga kryeministër

## "Çdo qendër votimi do të dokumentohet me video"

Kryeministri Edi Rama para kandidatëve socialistë për kryebashkiakë në zgjedhjet e 30 qershorit paralajmëroi mbështetësit e opozitës se do të veprojë ligji mbi ta, nëse tentojnë të dëmtojnë procesin zgjedhor. Madje, Rama shkon edhe më tej, duke folur edhe në emër të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian. Për ata që guxojnë të prekin ligjin duke penguar zgjedhësit të votojnë lajmëron se do të përfshihen në listën e zezë të BE dhe SHBA. "Nuk ia vlen të digjesh për politikën më kriminale të mundshme që të nxit të shkosh me këmbët e tuaja në duart e drejtësisë, por që mund të të fusë edhe në listën e zezë të të dënuarve për krimet zgjedhore që do u hiqet përgjithmonë e drejta e hyrjes në SHBA e BE", u shpreh z.Rama. Kryeministri paralajmëroi se flakët që po përzhisin imazhin e Shqipërisë në botë do të djegin Lulin dhe Partinë Demokratike. "Lulzim Basha imagjinon të paimagjinueshmen... Në rrugën e të paimagjinueshmes, të marrjes së pushtetit me bomba, ecën në ajër, pa e ditur se ku shkon... Masa e madhe e demokratëve që e ndjek nga ekrani ka nisur ta ndjejë se flakët që po përzhisin imazhin e Shqipërisë në botë, në Shqipëri do djegin Lulin dhe partinë e tyre".



Kryeministri Edi Rama dje me kandidatët për kryebashkiakë të PS-së

**ZGJEDHJET**

Kryeministri Edi Rama mblodhi 61 kandidatet socialistë për kryetarë bashkie me kërkesës për të nisin fushatën për zgjedhjet e 30 qershorit, datë që sipas tij nuk preket. Më e rëndësishme se pjesëmarrja, për Edi Ramën është mbarëvajtja e zgjedhjeve. Kryeministri Rama deklaroi para kandidatëve për kryetarë bashkie se zgjedhjet e 30 qershorit nuk kanë asnjë mundësi të shtyhen dhe asnjë shans të pengohen. "Askush, askund në asnjë cep të asnjë bashkie duhet të mos dyshojë më a do bëhen, apo nuk do bëhen zgjedhjet më 30 qershor. Kjo kërkon fushatën më intensive me njerëzit, duke folur dhe shpjeguar ABC-në e sistemit që kemi zgjedhur dhe treguar pa u lodhur pse zgjedhjet s'ka asnjë mundësi të shtyhen dhe asnjë shans të mos lejohen të zhvillohen", theksoi Edi Rama. Duke folur nga i njëjti vend (Pallati i Kongreseve) kur dy vite më parë u hartua marrëveshja mes tij dhe lideri demokrat Lulzim Basha, kryesocialisti pranoi që pakti i 2017-ës nuk ka funksionuar. Për Edi Ramën, zgjedhjet e 30 qershorit janë të rëndësishme për politikën shqiptare për të kuptuar se nuk ka më marrëveshje që mund të shkelin dhe mbi Kushtetutën. Ai tregoi përse nuk funksioni marrëveshja e plotë 2 viteve më parë. "Ajo marrëveshje nuk funksionoi dhe asnjë marrëveshje nuk funksionon, sepse PD ka ndërruar qime, por jo zakon dhe kuptohet zakoni është Saliu që nuk ndërron as qime, ndërsa Lulzimi është qimja që nuk bëhet dot zakon", u shpreh kreu i qeverisë.

**DORËHEQJA**

Kryeministri Edi Rama gjatë fjalës së tij para kandidatëve socialiste për kryebashkiakë të rinj në mbarë vendin theksoi se nuk do të largohet nga pushteti. "Po ua them të gjithë atyre që nga frika se mos të mbyturit do mbysin edhe Shqipërinë, siç e kanë mbytur në fakt herë tjetër, thonë po ja le të ikë Rama që të qetësohen të marrosurit në pushtet. Jo, kështu nuk qetësohen të marrosurit në pushtet. Por fillon rënia në batakun e marrisë pa shtet, pa drejtësi, pa rregull nga nisi e përpjeta jonë për ta rilindur Shqipërinë e për t'i dhënë këtij vendi trajtën e një shteti në një rrugë që është e gjatë, e përpjetë dhe sfilitëse. Unë jetoj dhe luftoj çdo ditë me bindjen se pushteti nuk është mundësi për të rrëmbyer, por privilegj për të shërbyer. Nuk është qëllimi, por fuqia për t'u ngjitur drejt qëllimit, nuk është karrigia nga ku nuk shkulesh se do të jesh mbi të tjerët, por detyra nga ku nuk ikën, sepse të tjerët të kanë zgjedhur të udhëheqësh. Jo, nuk iket nga kjo detyrë nga kundërshtarët, sepse nuk kanë popull me vete, aq më pak iket kur e kërkojnë kundërshtarët e bërë njësh me mjetet antidemokratike të rrugës ngaqë nuk të largojnë dot me rrugën e zgjedhjeve demokratike. Nga kjo detyrë iket vetëm kur e kërkojnë ata që ta kanë dhënë detyrën. Me votën e tyre si popull të zgjedhin apo me votën e tyre si përfaqësues të popullit në parlament. Unë nuk rri në këtë detyre pse më gënjen mendja se jam i pagabueshëm. Apo se s'kam bërë gabime, pse kujtojmë se çfarë po bëjmë është pa të sharë, apo shtetndërtimi po shkon vaj. As pse po mendoj se njerëzit po paguajnë para nën dorë për të marrë shërbimet e tyre, se rrogat janë rritur aq sa nuk mendohej, se gjithë shqiptarët po kthehen nga jashtë e kështu me radhë e se një fushë me lule është sot jeta e shqiptarëve. Jo, jo fare unë nuk i iki kësaj detyre, sepse në çdo drejtim kam nisur së bashku me ju dhe të gjithë ata që na besojnë e mbështesin një luftë që nuk ka shans ta lë në mes. Një luftë, ku përballem çdo ditë me probleme dhe ku nuk i gëzohem dot një arritjeje reale sepse 'boom' ballafaqohem me një shqetësim real", deklaroi z.Rama.

**DIALOGU**

Edi Rama ia bëri të qartë Lulzim Bashës se është i hapur për dialog, por pa hequr dorë nga posti i kryeministrit dhe 30 qershori. "Jam gati të ulem me Lulzim Bashën në çdo moment. Kushte nuk kam. Unë nuk i iki kësaj detyre, sepse kam nisur së bashku me ju një luftë që s'ka shans ta lë në mes", u shpreh Rama. Akuzat më të ashpra të kryeministrit u drejtuan ndaj Sali Berishës, që e akuzoi se ka frikë nga drejtësia. Ndërsa Bashën e paralajmëroi se me këtë sjellje pas 30 qershorit, demokratët do të kërkojnë largimin e tyre. "Janë boll 30 vjet, që i njëjti lider politik, në krye të së njëjtës parti, i cili si President i Republikës dogji Shqipërinë, duke e çuar në buzë të luftës civile, si shef opozite dogji Kryeministrinë, duke e sulmuar me antitank e me kallashnikov, nën synimin e verbër për të vrarë shefin e qeverisë dhe për të marrë pushtetin me dhunë, si kryeministër vrau dhe plagosi me armë zjarri protestues që armët e tyre më të rrezikshme kishin ristelat e pankartave të protestës, të vazhdojë sot të kërcënojë përsëri, me zjarr e flakë këtë popull, nga tmerri se mund t'i vijë më shpejt fletëthirrja e drejtësisë, sesa bileta e takimit me Shën Pjetrin", deklaroi Edi Rama.

**PARALAJMËRIMI**

"Kush i afrohet një qendre votimi me mendje të keqe djeg veten, jo zgjedhjet. Në çdo qendër votimi do të dokumentojmë me video, audio, fotografi çdo veprim në kundërshtim me ligjin, jo vetëm qeveria, e cila do ta bëjë detyrën e saj, por policia dhe çdo agjenci ligjzbatuese do të bëjnë detyrën e tyre. Ne do të bëjmë fushatë për demokracinë", - tha z.Rama.

## Zgjedhjet e 30 qershorit, porositë e kryeministrit për kandidatët

Edi Rama mendon se socialistët kanë qenë gjithmonë ata, që në politikën shqiptare u kanë hapur rrugën kundërshtarëve të tyre demokratë, madje edhe me kosto të larta për ta. Po aq sa zgjati pjesa e hapur për mediat zgjati dhe pjesa e mbyllur e takimit, ku Rama i porositi kandidatet të ruajnë qetësinë në fushatë të mos provokohen. Përveç opozitës, Edi Rama kishte edhe një mesazh për socialistët e tij. "Debatojmë përditë dhe zihemi për punët, por jo për kamerat. Marrim dhe kot ndonjëherë tavolinave, sidomos kur kemi sedër e na mbetet hatri, por zarare si ato të dikurshmet në dëm të qeverisjes së vendit dhe të familjes së madhe që drejtojmë, asnjëherë më, sepse kemi mësuar që prej zarareve humbasim të gjithë dhe të gjithë e dimë që kush bën zarare na humbet që të gjithëve", u shpreh z.Rama. Në këtë takim Rama u kërkoi kandidatëve për kryebashkiakë që duhet të dalin në terren dhe të bisedojnë me qytetarët për t'i shpjeguar se pse duhet të marrin pjesë në votime në 30 qershor. Gjithashtu, kryesocialisti u kërkoi të vetëve që të mos provokohen nga mbështetësit e opozitës, por të ruajnë qetësinë gjatë fushatës zgjedhore.

## Video-skandali/ Dorëhiqet kancelari i Austrisë: Nuk erdha në pushtet për karrige

Kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, ka dhënë dorëheqjen 18 orë pas publikimit të video-skandalit, ku zëvendëskancelari austriak, Heinz-Christian Strache, shfaq gatishmërinë për t'i siguruar një oligarkeje ruse mbështetje për tendera publikë, në cilësinë e kreut të Partisë së Lirë (FPÖ). Teksa shpalli edhe zgjedhjet e parakohshme, Kurz e komentoi dorëheqjen duke u shprehur se u zgjodh kancelar për të ofruar ndihmesën e tij për Austrinë dhe jo për të siguruar një karrige pushteti. "Unë nuk erdha në pushtet për karrigen time. As për të përmbushur një ego. Erdha për të dhënë ndihmesën për Austrinë, por nuk mund të qëndroj në pushtet në këtë situatë prandaj, sot jap dorëheqjen dhe thërras zgjedhje të parakohshme", - tha Kurz në reagimin e tij pas dorëheqjes. Kompromentimi i Strache-s parashikohej nëse FPÖ-ja do të ishte pjesë e formacionit qeverisës pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, në këmbim të mbështetjes financiare. Në zgjedhjet e fundit, FPÖ-ja arriti 26% të votave dhe u bashkua në një koalicion paselektoral me ÖVP-në. Videoja që u shpërnda nga prestigjiozet "Spiegel" dhe "Süddeutsche Zeitung" tregon për ambicien e oligarkes ruse për të blerë gazetën austriake me tirazhin më të lartë, "Kronen Zeitung", me qëllim që të mbështeste FPÖ-në në periudhën paraelektorale. Organi i akuzës ka nisur hetimet për çështjen në fjalë.

ZGJEDHJET
KONFLIKTI

Valentina Madani

PD padit sekretarin e Kuvendit: Çoi në KQZ dokument fals për deputetin e "Bindjes"

# Denoncimi, deputeti i LSI firmosi për të regjistruar "Bindjen" në KQZ

## *PD: Firma e Lefter Kokës nuk ka vlerë ligjore*



Sekretari për çështjet zgjedhore, Ivi Kaso

Partia Demokratike paditi dje për shpërdorim detyre sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit, të cilin e akuzon se në kundërshtim me ligjin ka lëshuar vërtetim fals për deputetin Andi Përmeti, në mënyrë që Bindja Demokratike të regjistrohet në zgjedhje. Sekretari për çështjet zgjedhore, Ivi Kaso publikoi një dokument sipas të cilit, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, Genc Gjonçaj ka lëshuar një vërtetim, ku thuhet se deputeti i Bindjes Demokratike, Andi Përmeti është deputet prej 6 muajsh, çka i jep të drejtë kësaj force politike të regjistrohet në zgjedhje vendore. "Në një akt të paprecedentë, për llogari të Edi Ramës, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit ka falsifikuar dokumentet zyrtare, duke lëshuar për partinë fantazmë të Edi Ramës një vërtetim, sikur përfaqësohet në Kuvend nga një deputet që ka 6 muaj që ushtron mandatin e tij. Bëhet fjalë për deputetin Andi Përmeti, i cili nuk ka mbushur as 1 muaj në marrjen e mandatit", deklaroi z.Kaso. Gjithashtu, PD paralajmëroi anëtarët e KQZ-së dhe KZAZ-ve që do të mbajnë përgjegjësi penale për çdo shkelje të ligjit me kandidatë të regjistruar me dokument fals. Sipas ligjit, për t'u regjistruar në zgjedhjet vendore, një kandidat duhet të paraqesë një vërtetim se partia politike zotëron një mandat deputeti të paktën 6 muajit e fundit, në të kundërt, duhet të mbledhë firma nga votuesit e secilës zonë ku kandidon.

**REAGIMI**

Koordinatori i Bindjes Demokratike, Astrit Patozi publikoi dje dokumentin, sipas te cilit Bindja Demokratike ka firmat e dy deputetëve për të garuar dhe kandiduar në të gjithë Shqipërinë, Andi Përmetin dhe Lefter Kokës. Patozi shkruan se partia e vetëdjegur e Lulzim Bashës nuk do të pengojnë dot kurrë Bindjen Demokratike të garojë në 26 bashki me kandidatë për kryetar dhe në 55 të tilla me kandidatë për këshillat bashkiakë. "Sot (dje) paskan shpikur që kandidatët tanë qenkan të paligjshëm, sepse nuk u mbështeskan nga një mandat deputeti në të paktën 6 muajt e fundit. Sqarojmë publikun se Bindja Demokratike mbështetet jo nga një, por nga firmat e dy deputetëve për të garuar dhe kandiduar në gjithë Shqipërinë. Ata janë zotërinjtë Lefter Koka dhe Andi Përmeti dhe për këtë ekziston e gjithë praktika e depozituar në KQZ. Përgjuesit tanë të palodhur bëjnë sikur nuk e kanë parë këtë dhe flasin për paligjshmëri. Dhe që ta mbledhin mendjen një herë e mirë e mos të lodhen kot, duke u përpjekur çdo ditë të na kapin në gabim, po u themi sot se Bindja Demokratike i ka kapur të gjitha afatet dhe detyrimet ligjore për të konkurruar në 26 bashki me kandidatë për kryetar dhe në rreth 55 të tilla për lista këshilli. Madje, në shumë raste ne kemi pasur edhe firmat e qytetarëve të disa bashkive, përveç atyre të deputetëve, që ishin kriter i mjaftueshëm, sipas ligjit. Si përfundim, i ftojmë që të qetësohen ata që kanë zgjedhur të na ndjekin ne e të mos hyjnë vetë në zgjedhje. Ata nuk do të na pengojnë dot kurrë që ne të marrim pjesë dhe të garojmë në procesin e pandalshëm të 30 qershorit", shprehet z.Patozi.

**AKUZA**

Partia Demokratike e ka cilësuar si gënjeshtër deklaratën e kryetarit të Bindjes Demokratike, Astrit Patozi se regjistrimi i forcës së tij politike është bërë në përputhje me ligjin. Në një deklaratë të shpërndarë për mediat, PD shprehet se mbështetja nga deputeti Lefter Koka për Bindjen Demokratike nuk ka vlerë ligjore. Sipas PD-së, të gjithë kandidatët e "Bindjes" janë të paligjshëm, pasi kjo forcë politike nuk ka 6 muaj që është krijuar. "Asnjë justifikim me deputetë falsë apo të marrë me qira nuk mund ta mbulojnë faktin se aktorët e Edi Ramës, të regjistruar si kandidatë me siglën e paligjshme të Bindjes Demokratike, janë gjithashtu të paligjshëm. Shërbëtori i bindur i Edi Ramës nuk zotëron një mandat deputeti në Kuvend dhe për pasojë duhet të kishte firma mbështetëse të qytetarëve për të regjistruar kandidatë në zgjedhje. Mbështetja nga një deputet që nuk është deputet i tij, si në rastin e Lefter Kokës, nuk ka vlerë ligjore. Partia Bindja Demokratike nuk ka 6 muaj që është krijuar e jo më të zotërojë për të paktën 6 muaj një mandat deputeti në Kuvend", thuhet në reagimin e demokratëve. PD thekson se me apo pa parti e kandidatë falsë, votime moniste më 30 qershor nuk ka për të pasur.

**GENC GJONÇAJ**

Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, Genc Gjonçaj, shprehet se nuk ka asnjë shkelje ligjore në dokumentin që i është paraqitur KQZ-së për deputetin Përmeti. Sipas tij, pika 3 e nenit 68 përcakton se për t'u regjistruar në zgjedhje, partia duhet të ketë mandat deputeti në 6 muajt e fundit dhe Përmeti zotëron mandat që prej 25 prillit të këtij viti.

### Hajdari: Zullumqarët po përgatisin marrëveshjen e radhës

## Opozita me komisionerë në zgjedhje, PD e LSI dorëzojnë listat në KQZ

Opozita do të ketë komisionerët e saj në zgjedhjet e 30 qershorit, edhe pse ka vendosur të mos regjistrojë kandidatë për pushtetin vendor. PD dhe LSI depozituan dje pranë KQZ-së emrat e anëtarëve për 90 komisionet zonale të administrimit zgjedhor. Sekretari për çështjet zgjedhore, Ivi Kaso, u paraqit në KQZ bashkë me përfaqësuesin e LSI-së për të dorëzuar listën me emrat e komisionerëve. PD dhe LSI, edhe pse nuk do të garojnë në zgjedhje kërkuan të shfrytëzojnë të drejtën ligjore për të pasur anëtarët e tyre në komisione. Deputetja Rudina Hajdari e cilësoi si të paligjshëm dërgimin e komisionerëve të PD e LSI në KZAZ. Hajdari duke u ndalur te marrëveshja e dy viteve më parë mes Ramës e Bahës, i akuzon ata se po përpiqen të bëjnë një tjetër marrëveshje në kurriz të shqiptarëve. Sipas Hajdarit, opozita nuk mund të mbajë një dorë në bakllava e një në revani, pasi kjo gjë tregon papërgjegjshmëri dhe pengon procesin zgjedhor. "Është e paligjshme! Në përvjetorin e marrëveshjes që mori të majtën për tatëpjetë dhe të djathtën për lum, asnjë nuk mund të përligj tentativën e dytë, qoftë ky celibash i oborrit të gjeneralit hije me ushtri të mpirë, apo çaush i kryetarit në tentative të legjionit të shpërbërë. Zullumqaret përgatisin shtratin për marrëveshjen e radhës, duke tentuar të legjitimojnë prezencën e PD-së në komisione pa çuar njerëz në KZAZ dhe duke pretenduar të mos futen në zgjedhje. Nëse kryetari i legjionit kërkon që gjeneratli hije të mbaje përgjegjësi për të gjitha zullumet e këtyre viteve dhe degradimin ekstrem të Shqipërisë, atëherë vetë nuk mund të mbajë një dorë në revani dhe një dorë në bakllava, nuk mund të jetë edhe në zgjedhje, edhe pa zgjedhje kur akoma nuk ka sqaruar elektoratin e djathtë e prerë në besë me imponimin e dorëzimit të paprecedentë të mandateve si t'i kishin absolutisht personale", shprehet Hajdari.

### OMONIA: Rama bllokoi kandidimin e një greku në Himarë

## Pjesëmarrës në masakrën e Peshkëpisë, KQZ refuzon Belerin: Në hetim për vrasjen e dy ushtarëve shqiptarë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve refuzoi kandidaturën e Dhionisios Alfred Belerit për të garuar si i pavarur në zgjedhjet e 30 qershorit 2019. Beleri ishte regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhjet për Bashkinë e Himarës, por pas verifikimeve të kryera në formularin e dekriminalizimit, KQZ-ja ka marrë vendimin për ta refuzuar kërkesën e tij. Shkak për këtë vendim është bërë një vendim gjyqësor i formës së prerë i dhënë ndaj tij vite më parë. Para dy muajsh Prokuroria e Krimeve të Rënda rihapi hetimet për masakrën e Peshkëpisë, ku mbetën të vrarë dy ushtarakët shqiptarë, Fatmir Shehu dhe Arsen Gjini, të cilët u sulmuan nga një bandë e armatosur greke në mesnatën e 10 prillit 1994. Në këtë çështje sipas prokurorisë person nën hetim është edhe Fredi Beleri. Pak pasi KQZ-ja i refuzoi kandidaturën e Dhionisios Alfred Beleri për të garuar si i pavarur me 30 qershorit në Himarë, reagoi Ministria e Jashtme greke. Në një deklaratë të publikuar më 17 maj në faqen zyrtare, Ministria e Jashtme greke shkruan se vendimi i KQZ-së nuk ka baza ligjore, ndërsa po ndjek me shqetësim zhvillimet. "Një shqetësim i veçantë është vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Shqipëri, i përbërë nga përfaqësues të partive shqiptare, për të hedhur poshtë kandidaturën e Fredi Belerit për postin e kryetarit të komunës në zgjedhjet e ardhshme vendore. Sipas asaj që dihet deri tani, ky vendim nuk ka bazë ligjore. Ne po ndjekim zhvillimet dhe jemi gati të ndihmojmë përfaqësuesit e pakicës minoritare", - thuhet në njoftimin e Ministrisë së Jashtme të Greqisë.



## "Niçja" e Shijakut kërkon për të 5-ën herë lirinë, Krimet e Rënda refuzojnë kërkesën

**TIRANË** - Gjykata për Krimet e Rënda ka refuzuar ditën e djeshme kërkesën për lirim nga qelia të Altin Avdylit, i arrestuar si pjesë e grupit të Avdylajve gjatë operacionit të koduar "Volvo 4". I njohur edhe me pseudonimin "Niçja", ai kërkoi zbutje të masës "arrest në burg", duke pretenduar mungesë të provave dhe se deri në këtë moment nuk ka pasur të reja nga hetimet. Nga ana tjetër, prokurori i çështjes, Dritan Prençi kërkoi lënien të pandryshuar të masës me argumentin se nuk ka kushte të reja ligjore që mund të çojnë në ndryshimin e saj dhe se provat e paraqitura janë të mjaftueshme për të caktuar një masë sigurimi. Kjo është hera e pestë që Altin Avdyli kërkon lirim nga qelia.

### Kryebashkiaku i Durrësit doli në përgjime duke folur me Avdylajt e Shijakut

# "Dosja 339", Vangjush Dako pyetet për 5 orë në prokurori

## *Niçja komunikonte në celular për votimet e 2017-ës*

"Vol Vo 4", megaoperacioni i Policisë së Shtetit në kuadër të luftës ndaj krimit të organizuar, rezultoi të ishte vetëm maja e ajsbergut në atë ç'ka do të denoncohej ditët në vijim në media, ndërsa protagonist vijon të mbetet kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako. Arrestimi i Avdylajve në Shijak zbuloi atë ç'ka përflitej nën zë prej thuajse një viti nga opozita, por edhe biseda gazetarësh apo studio televizive. "Vol Vo 4" nxori në pah odisenë e dosjes së shumëpërfolur '339', fletë të së cilës tashmë nuk janë më sekret hetimor. Referuar dosjes, mediat raportuan se Avdylajt kishin lidhje me zyrtarë të lartë, një prej të cilëve me pseudonimin "Xhuxhi", ndërsa shumë prej tyre guxuan të thonë edhe se bëhej fjalë për kreun e Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dakon. Ndërkohë, 25 tetorin e vitit që lamë pas, përmes dokumenteve ekskluzivë, emisioni "Të Paekspozuarit" i gazetarit Ylli Rakipi në "News 24", publikoi të zezën mbi të bardhë, një përgjim në të cilin kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako komunikonte në telefon me Altin Avdylajn, i njohur me pseudonimin "Niçja". Në bisedën e përgjuar ku Altin Avdylaj identifikohet si "Niçja", ndërsa Dako vetëm me numrin e telefonit, kryetari i Bashkisë së Durrësit falënderon Avdylajn dhe i kërkon të takohet. Biseda e parë është zhvilluar më datë 27 qershor, në orën 11:08 dhe zgjat 1 minutë e 3 sekonda.



Kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako

**BISEDA E PARË**

**Niçja:** Hë kryetar, hë vllai.

0692099300: Niçe, ku je?

**Niçja:** Këtu vërdallë…

0692099300: Ku është Astriti?

**Niçja:** Ka lëviz njëçikë.

0692099300: Ku ka lëviz? Jashtë Durrësit?

**Niçja:** Eh… ça ka? Ka ndonjë gjë?

0692099300: Po jo mo, doja ta takojsha, ta falenderojsha, ta pyesja njëçikë.

**Niçja:** Po, po ku je ti? Të vij të të takoj…

Njësoj është, si ai si unë, e di që jemi një.

0692099300: Po mirë mo mirë, por doja ta takoja… kanë pi ata.

**Niçja:** Po, e di po kanë lëviz… Me të taku njëçikë unë ty!

0692099300: Unë tani jam duke ardh nga… rrugës… rrugës…

**BISEDA E DYTË**

Biseda e dytë është bërë nga numri i telefonit 069 56 39 642 (i paidentifikuar) drejt numrit 0898967765 (Altin Avdylaj) në orën 20:06 të mbrëmjes me kohëzgjatje 31 sekonda, një ditë para zgjedhjeve të 25 qershorit.

**Niçja:** Të marr unë se jam me rob pra…

Alo, ça po bën?

**Niçja:** Të marr unë se jam me rob të thashë!

Ku je? Je andej nga fshatrat, ku ishe?

Jo! Jo! Jo!

Kam ca me mbiemër Kurti, kam zonjën këtu…

… po desha…

**Niçja:** …mirë…

6 veta janë!

**Niçja:** Hajt se të marr unë!

Thuaj Vangjushit t'i japim ndonjë lek, që të votojnë!

Dyshimet që lindin nga këto biseda janë se Vangjush Dako e ka përdorur për qëllime elektorale të PS-së, bandën e trafikut të kokainës në Shijak, duke vërtetuar tezën e opozitës se Rilindja i ka toleruar bandat, duke kërkuar si këmbim ndihmën e tyre në zgjedhje. Vetëm një javë më pas, "Të paekspozuarit" publikuan materiale të reja mbi dosjen '339'. Bëhet fjalë për një përgjim të datës 20 shkurt të vitit 2017, saktësisht biseda është zhvilluar në orën 17:26. Në përgjim sipas 'TPZ' përfshihet kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, teksa komunikon me Altin Avdylajn (Niçja) dhe i premton se do t'i zgjidhë diçka, prandaj nuk duhet të merakoset.

**PËRGJIMI:**

0698967765: **Hë Gjushi**?

0692099300: **Hë Niçe**.

0698967765: **Hë vëlla**.

0692099300: Hë se jam duke fol me atë, mos e ki merak, ç'ke ti, o nesër… këto ditë do ta mbaroj unë, mos e ki merak?

0698967765: E të lutem!

0692099300: Ik, pa merak.

Më 30 janar të këtij viti, "Zëri i Amerikës" publikoi një tjetër pjesë të dosjes "339", ku jo vetëm tregohet qartë blerja e votave në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017, por dilte në pah marrëdhënia e ngushtë e Vangjush Dakos me Avdulajt e Shijakut. Dhjetëra përgjime dhe dokumente të siguruara nga BIRN përmes dy hetimeve në Prokurorinë e Krimeve të Rënda hedhin dritë mbi përfshirjen e krimit të organizuar në episode të blerjes së votës në Durrës, Kavajë, Lezhë dhe Dibër, ndërkohë që Shqipëria po shkon drejt një procesi të ri zgjedhor.

Komunikimet dhe bisedat për takime me Dakon datojnë në janar të vitit 2017 dhe shtrihen deri në shkurt të vitit 2018. Ato kanë si objekt probleme nga më të ndryshmet si dhe koordinimet për dreka mes tij dhe vëllezërve Avdylaj.

**PËRGJIMI 1 (DATË 11 SHKURT 2017)**

**Altin Avdylaj:** Ne me atë shokun jemi tuj hangër bukë, me Gjushin. Të hanën e patëm lanë të vish me e taku, megjithatë po e takoj me babën tat, Isakun.

**I panjohur:** Shife vetë o burrë, nuk ka problem, se vij unë, nuk ka problem.

**Altin Avdylaj:** Jemi me Astritin, të hanën e kemi lënë. Jemi te 'Maxhestiku' me Gjushin t'u hangër një drekë.

Gazetarja Klodiana Lala ka zbuluar një tjetër përgjim nga dosja '339', pak orë pasi prokuroria tha se ka hapur hetime për rrjedhje informacioni dhe nxjerrje sekreti. Përgjimi tregon një telefonatë mes kryetarit të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako dhe Astrit Avdylajt, i akuzuar si koka e grupit kriminal me bazë në Shijak.

**Dako:** Niçe si je? I bëre gati letrat?

**Avdylaj:** Po kryetar i bëra.

**Dako:** Çoji te vendi se është bërë gati.

**Avdylaj:** Faleminderit kryetar!

"Unë kam dokumente të tjera, ku Dako flet me Avdylajn edhe për biseda që kanë të bëjnë me favore, për shembull në një rast është Dako që e merr në telefon Astrit Avdylajn", - u shpreh Lala në "Opinion". Por, ndërsa çështja është në përmasat e një skandali, kryebashkiaku i Durrësit vijon të shfaqet në studiot televizive, herë si "superman" apo si "kloun" në emisionin e fundit "Open" të Eni Vasilit ndërsa tha se kur ha dreka me dikë nuk i interesojnë precedentët penalë…

### Parfumi me dedikim "tradhtoi" grupin që bastisi 70 apartamente në Francë

Mos vidh nëse nuk di të fshehësh. Kjo shprehje popullore i përshtatet më së miri rastit të Alfons Përkolës, një prej tetë të arrestuarve si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal që kryente grabitje në Francë. Gjatë bastisjes së një vile, anëtarët e bandës, veç të tjerash morën edhe një parfum të personalizuar, pa e ditur se ai do të bëhej prova e fortë e institucionit të akuzës kundër tyre. Parfumi u gjet gjatë kontrollit në shtëpinë e Përkolës. Në shishen e tij ishte gdhendur urimi "Gëzuar Krishtlindjen". Francezja Lambotte Dominique ishte në mesin e dhjetëra personave që kishte denoncuar vjedhjen e banesës së saj nga persona të paidentifikuar. "Kanë marrë lekët e vajzës tonë, të cilat gjendeshin në një kuti të vogël metalike të dhomës së saj, në bibliotekë një shumë prej 250 eurosh, si dhe një parfum 'One Million Paco Rabane', ku ishte shkruar emri i bashkëshortit tim 'Ferdinand'. Ai gjendej në komodinën e dhomës sonë të gjumit.

### Paralizuan me lëng dhe grabitën tregtarin, kapet i katërti në Peqin

**ELBASAN** - Policia e Elbasanit ka vënë në pranga një 19-vjeçar të shpallur në kërkim për grabitjen e tregtarit 76-vjeçar, Skënder Zeqiri. Ngjarje kjo e ndodhur më 8 maj në Peqin, ku të moshuarit dyshohet se i dhanë edhe lëng paralizues. Ky është autori i katërt i dyshuar për "Vjedhjen me pasoja të rënda e kryer në bashkëpunim".

Ndërkohë që tre të tjerë, bashkë me vajzën që akuzohet se e futi në kurth të moshuarin janë arrestuar më herët. "Shërbimet e Komisariatit të Policisë Peqin, në vijim të punë për kapjen e personave të shpallur në kërkim, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative kanë bërë të mundur lokalizimin, kapjen dhe ndalimin e shtetasit S.I., 19 vjeç, banues në Peqin, i cili ishte i shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Peqin. Kapja dhe ndalimi i tij u bë pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur masën e sigurisë 'Arrest në burg', pasi më datë 08.05.2019, në Peqin, ky shtetas në bashkëpunim me shtetasit B.H., M.LL., dhe E.SH., të cilët janë arrestuar më parë kanë hyrë në banesën e shtetasit S.Z. dhe kanë vjedhur një sasi parash. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan për veprimet e mëtejshme", njoftoi policia.

Specialistët: Niveli i jodit është më i ulët se kufiri i lejuar

# AKU fut tri javë në karantinë 42 viça, që hynë nga Serbia në doganën e Morinës

## *Bllokohen në Han të Hotit 24 tonë kripë nga Austria*

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bllokuar në doganën e Morinës në Kukës 42 viça, të cilët do mbahen në karantinë për tri javë me dyshimin se janë të prekur nga sëmundja. Ndërsa në doganën e Hanit të Hotit në Shkodër janë bllokuar dhe janë kthyer në vendin e origjinës, në Austri, 24 tonë kripë, pasi rezultoi se niveli i jodit është më i ulët se kufiri i lejuar.

**BLLOKIMI I VIÇAVE NGA SERBIA**

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, njëkohësisht me intensifikimin e kontrolleve në terren, vijon të kontrollojë me rigorozitet çdo ngarkesë me mallra ushqimore që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Pikave të Inspektimit Kufitar. Nga kontrollet e ushtruara më datë 17 maj 2019 rezulton se ngarkesa me kafshë të gjalla të ardhura nga Serbia (42 krerë viça për therje) në Pikën e Inspektimit Kufitar në Morinë u kontrollua për përputhshmërinë me kërkesat ligjore për masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Dermatozës Nodulare, siç përcaktohen në Urdhrin Nr. 526, datë 20.10.2016. Referuar parashikimeve të këtij urdhri dhe në bashkëpunim me shërbimin veterinar rajonal, AKU vendosi mbajtjen e këtyre kafshëve të gjalla në regjim karantinor (21 ditë) përpara se të futen në proces therjeje.

**BLLOKIMI I KRIPËS NGA AUSTRIA**

Ngarkesa prej 24 tonë kripë e ardhur nga Austria në Pikën e Inspektimit Kufitar Hani i Hotit për t'u përdorur për konsum human dhe industrinë ushqimore në Shqipëri u kontrollua për përputhshmërinë me kërkesat ligjore për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut (Ligji nr 9942 datë 26.06.2008, neni 6). Gjatë kontrollit të dokumentacionit përkatës si dhe pas kontrollit fizik të ngarkesës ka rezultuar se certifikata e analizës dhe etiketa e produktit kripë paraqesin nivelin e jodit më të ulët se kufiri i lejuar sipas përcaktimeve ligjore (nivel jo me të ulët se 40 mg jod dhe jo me të lartë se 60 mg jod për kg kripë).

Për këto arsye, AKU vendosi masën administrative "bllokim" produkti për sasinë prej 24 tonë kripë dhe masa administrative "kthim në vendin e origjinës" së produktit. Subjekti po kryen veprimet e duhura me degën e doganës Shkodër për kthimin e produktit në vendin e origjinës. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vijon pandërprerë kontrollet për të siguruar zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të konsumatorëve, si dhe shprehet i vendosur për të mos toleruar asnjë shkelje të ligjit në dëm të jetës së konsumatorëve.



Kamioni me viça

## Shpërndanin kokainë e kanabis, 4 në pranga dhe 2 nën hetim

**TIRANË** - Policia e Tiranë ka finalizuar operacionin antidrogë të koduar "Orët e vona", që ka çuar në goditjen e dy rasteve, një për shpërndarje të kokainës dhe një për shpërndarje të kanabisit. Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë në bashkëpunim me forcën e posaçme "Shigjetat" gjatë këtij operacioni vunë në pranga 4 persona, ndërsa janë proceduar në gjendje të lirë dy të tjerë. Mësohet se janë arrestuar shtetasit A.B., 31 vjeç, banues në Tiranë për veprat penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike" dhe "Përshtatje e lokalit për përdorim droge" dhe A.K., 23 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike", "Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", person me precedentë të theksuar kriminalë për lëndë narkotike, vjedhje, krime kundër personit dhe për armëbajtje pa leje dhe shtetasi E.M., 26 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike", "Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", person me precedentë të theksuar kriminalë në fushën e narkotikëve. Si dhe u procedua në gjendje të lirë shtetasi A.D., 26 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Moskallëzim Krimi". Mësohet se personat e mësipërm u kapën në flagrancë në Tiranë pas marrjes së informacioneve në rrugë operative se në rrugën "Sulejman Delvina" në një lokal bar-kafe, persona të ndryshëm e frekuentonin duke pirë e shpërndarë lëndë narkotike. Nga kontrolli i kryer nga e punonjësve të policisë, në ambientet e lokalit, të cilin e kishte me qira dhe menaxhonte shtetasi A.B., policia gjeti dhe sekuestroi 12 doza të dyshuara me lëndë narkotike kokainë. Në momentin e kontrollit nga policia në lokal ndodheshin shtetasit A.B., A.K., E.M. dhe A.D, të cilët janë shoqëruar në DVP Tiranë dhe në përfundim të veprimeve është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasve E.M., A.K., A.B., ndërsa u procedua në gjendje të lirë shtetasi A.D., si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 12 doza kokainë, 4 aparate celular dhe 1 automjet. Gjithashtu, gjatë operacionit në fjalë është kapur në Laprakë shtetasi L.B., të cilit gjatë kontrollit të ushtruar në trup i është gjetur një sasi kanabisi. Pas një pune të mirëfilltë hetimore nga ana e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, u bë i mundur identifikimi i personit, i cili ia ka shitur këtë sasi lënde narkotike shtetasit L.B., që është shtetasi R.T. 21 vjeç, lindur në Tiranë, i dënuar më parë për "Vjedhje". Ky i fundit u arrestua, por në momentin e shoqërimit ka kundërshtuar me dhunë punonjësit e policisë.





## Shkëmbimi i informacionit në Ballkan, Veliu takim me homologët

**Drejtori** i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, mori pjesë në takimin e 12 drejtorëve të policive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili u zhvillua më 16 deri më 17 maj 2019, me mbështetjen e BE-së. Qëllimi i këtij takimi ishte rëndësia e shkëmbimit në kohë reale të informacionit kriminal, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet policive dhe agjencive ligjzbatuese në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, si dhe për gjetjen e mënyrave më efikase për të përballuar sfidat në të ardhmen. Në takim morën pjesë edhe Interpol, Europol, Selec, Frontex.

Ardi Veliu gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim ka falënderuar organizatorët dhe palën mikpritëse, duke e cilësuar këtë takim si shumë të rëndësishëm. Ai është shprehur se tashmë Policia e Shtetit është një organizatë e rritur profesionalisht dhe e aftë për të përballuar sfidat e kohës. "Policia e Shtetit e ka prioritet kryesor bashkëpunimin me partnerët dhe gjatë veprimtarisë së saj ka vetëm një objektiv, luftën pa kompromis ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimit në përgjithësi. Kjo vërtetohet qartësisht, ku partnerëve të Policisë së Shtetit u është vënë në dispozicion hapësira ajrore për të monitoruar nga ajri, me qëllim parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, hapësira detare GDF-së për të patrulluar bashkërisht në parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme, por edhe dhjetëra operacione të suksesshme ndërkombëtare, ku Policia e Shtetit është vlerësuar nga SELEC me çmim të parë, por edhe nga agjenci të tjera ligjzbatuese për disa operacione të suksesshme. Të gjitha këto tregojnë për besueshmëri të partnerëve te Policia e Shtetit", tha drejtori i përgjithshëm i policisë.


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,000,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapraksit pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 10 Qershor 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**Shoqeria permbarimore JUSTITIA:**

Shoqeria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e pare, për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilen ka vene hipoteke ALPHA BANK, me këto të dhëna:

**Apartament me nr.pas.7/21+1-4, zk.8360, vol.26, fq. 204, me sip 138.40 m2, Rruga "Zenel Baboci" Tiranë, në pronësi të z.Gentian Kujtim TOSKU. Cmimi me te cilin fillon ankandi eshte 124.006 Euro ( njëqind e njëzetë e katër mijë e gjashtë eur ).**

Ankandi zhvillohet në datën **30.05.2019,** në përfundim të orarit zyrtar, ora **16:30** në zyrën e përmbaruesit gjyqësor me adrese Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

### Raporti i tremujorit të parë të vitit 2019

# Konfindustria, borxhi për TVSH-në ndaj biznesit, mbi 120 milionë euro



Konfindustria vlerëson se raporti i fundit i misionit të monitorimit të FMN/ Fondit Monetar Ndërkombëtar duhet të shërbejë si një sinjal i qartë për vendimmarrjen politike, për të ndryshuar në mënyrë thelbësore politikat ekonomike, financiare dhe fiskale të deritashme. Gjithashtu, përfundimet e raportit të muajit maj 2019 të misionit të FMN-së mund të lexohen edhe si një lëvizje taktike pararendëse e institucionit në fjalë, ngjashëm me qëndrimin e mbajtur ndaj skemave piramidale të viteve 1996-'97, për t'ia lënë të gjithë përgjegjësinë e mungesës së efektivitetit të deritashëm të politikave fiskale dhe ekonomike vetëm Qeverisë së Shqipërisë, në përpjekje për të shmangur pjesën dhe rolin e saj. Konfindustria vlerëson se të dhënat e tremujorit të parë të vitit 2019 tregojnë për vazhdimësi të rezultateve të dobëta financiare në vijim edhe të problematikave të vitit paraardhës. Niveli i lartë i borxhit publik prej të paktën 70% të PPB, mbi 120 milionë euro detyrime të TVSH-së të pakthyer biznesit deri në fund të 3-mujorit të parë 2019, rënia e ndjeshme me 15-20 pikë e parashikimit të rritjes ekonomike, ulja e ndjeshme e të ardhurave nga TVSH, vazhdimësia e kreditimit të biznesit në nivelet më të ulëta historike, rritja e ndjeshme e pranisë së kreditimit informal/fajde etj., tregojnë për performancë të ulët fiskale josezonale, por me rrënjë të thella strukturore të ekonomisë kombëtare si dhe politika fiskale, financiare dhe ekonomike jo të duhura në shumicën e tyre. Konfindustria vë në dukje se pavarësisht qëndrimit të fundit kritik, FMN ka pjesën e saj të madhe të bashkëpërgjegjësisë në ndërtimin dhe zbatimin e politikave fiskale, të filluara në rastin e marrëveshjes së huas të vitit 2014. Lejimi i rritjes së menjëhershme të borxhit publik të vendit me pothuaj 10% të PPB si pasojë e huamarrjes të mbi 1.3 miliardë euro në 5,6 vitet në vazhdim të marrëveshjes e pashoqëruar me një program të qartë të reformave strukturore ekonomike është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e FMN. Gjithashtu, mungesa qartësisë së drejtimit të shpenzimeve buxhetore, rritja e barrës fiskale, kalimi i menjëhershëm dhe i pastudiuar nga politika e tatimit të "sheshtë" në përpjesëtimor, rritja e taksave për karburantin, energjisë etj., thellimi i skajshëm i politikave koncesionare pa garë dhe PPP, ndryshimet e shpeshta të politikave fiskale për biznesin në përgjithësi dhe biznesin e vogël në veçanti, etj., prishja e uniformitetit të fiskalitetit për sektorë të ndryshëm të ekonomisë etj., janë anashkaluar në vite nga misionet dhe përfaqësuesit e FMN në Shqipëri.

### Rënie e eksporteve në prill, INSTAT: Eksportet e mallrave arritën vlerën 27 miliardë lekë

# Eksportet ranë me 2.3%, deficiti tregtar rritet me 17.4%

## *Ngadalësimi i ekonomisë evropiane po godet kompanitë shqiptare*

Në muajin prill të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 miliardë lekë. Eksportet ranë me 2.3% dhe deficiti tregtar rritet me 17.4%. Krahasuar me muajin mars të këtij viti, dallohet një rënie me 4.1%. Në krahasim me muajin prill të vitit 2018, eksportet kanë pësuar një rënie të lehtë me 0.2%. Të dhënat janë bërë të ditura në raportin e fundit të Institutit të Statistikave, ku mësohet se importet në prill arritën vlerën e 57 miliardë lekëve, duke pësuar një rritje me 8.4% në krahasim me prillin e 2018-ës dhe me 1.6% krahasuar me marsin e 2019-ës. Deficiti tregtar i këtij muaji është 30 miliardë lekë, duke u rritur me 17.4% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 7.3% krahasuar me muajin mars 2019.

**RAPORTI DHE**

Problemet ekonomike të eurozonës kanë filluar të japin efektet e para negative edhe në ekonominë shqiptare. Instituti i Statistikave raportoi se në katër muajt e parë të vitit, shitjet e kompanive shqiptare në tregjet e huaja ranë me 2.3 për qind, të dëmtuara nga ecuria negative e eksporteve të energjisë, materialeve të ndërtimit, por edhe ato të fasonit. Ngadalësimi i ekonomisë europiane dhe veçanërisht vendeve kyç partnere të Shqipërisë si Greqia dhe Italia po godet kompanitë shqiptare që punojnë për eksport. Të dhënat e fundit zyrtare nga Instituti i Statistikave tregojnë se në katër muajt e parë të vitit eksportet ranë me 2.3 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kësaj rënieje ka ardhur nga eksportet e energjisë elektrike dhe naftës, të cilat sipas INSTAT ishin 5 miliardë lekë më pak se vjet. Por ndonëse rënia e eksporteve të energjisë ishte e pritshme për shkak të krizës hidrike, tendenca negative ka përfshirë edhe grupet e tjera të mallrave. Sipas INSTAT, një tjetër zë ku eksportet kanë shënuar rënie të ndjeshme krahasuar me vitin e mëparshëm është ai i materialeve të ndërtimit dhe metalet. Eksportet e këtij grupi ranë me 1.5 miliardë lekë në terma vjetorë, teksa kompanitë që prodhojnë materialet e ndërtimeve duket se kanë pasur më pak kërkesë për produktet e tyre në tregjet e huaja. Ecuri të dobët kanë shënuar edhe eksportet e industrisë së fasonit, që është edhe zëri më i rëndësishëm i eksporteve shqiptare. Sipas INSTAT, në katër muajt e parë të këtij viti, eksportet e fasonit ishin në stanjacion, e madje me një rënie të lehtë krahasuar me vjet. Të vetmet grupe me ecuri pozitive të eksporteve janë artikujt bujqësorë dhe makineri pajisjet. Por, rritja e shënuar në këto dy zëra ka qenë e pamjaftueshme për përmbysur tendencën negative në grupet e tjera.



### Paketë për mbështetjen e blektorisë

# Çuçi: Fermat me cikël të mbyllur garantojnë produkte me cilësi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së shpejti pritet të përgatisë një paketë të veçantë për mbështetjen e blektorisë, nëpërmjet subvencionimit. Këtë gjë e ka bërë të ditur ,inistri Bledi Çuçi gjatë vizitës së tij në një kompleks blektoral në Fushë- Krujë. "Ndërsa bujqësia po performon më mirë, siç shihet në fakt edhe nga rritja e eksporteve, blegtoria ka nevojë që të subvencionohet më shumë. Do të gjejmë mekanizmin më të mirë për të bërë ndërhyrjen e duhur në mënyrë që të mbështeten fermerët që mbarështojnë gjedhin, delet apo dhitë", - tha ministri. Teksa pa nga afër gjithë procesin që nga mënyra e ushqimit të bagëtive, kontrollin veterinar të tyre dhe gjithë ciklin e prodhimit të qumështit ministri foli për produkte me cilësi të lartë. "Kjo fermë është një dëshmi e qartë që në Shqipëri produktet e qumështit garantojnë cilësi dhe standarde të larta, sepse që nga ushqimi i bagëtive deri te produkti final në dyqan, i gjithë cikli është i mbyllur këtu", - tha ministri Çuçi.


**Nga ana e Shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk eshte shpallur ankandi faza e dyte per pasurine e meposhtme:**

**1-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 5,960 m2 dhe me siperfaqe ndertese 502 m2 me numer pasurie 28/39 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.972 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571,Volumi 15 Faqe 62 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 616,000 (gjashteqind e gjashtembedhjete mije) Euro.**

**2-"Truall "** me siperfaqe 4,730 m2 me numer pasurie 28/70 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.973 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571, Volumi 18 Faqe 143 me adrese Lushnje .
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 185,416 (njeqind e tetedhjete e pese mije e katerqind e gjashtembedhjete) Euro.**

**3-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 2,400 m2 dhe me siperfaqe ndertese 840 m2 me numer pasurie 28/58 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.653 date 25.10.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 15 Faqe 235 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 308,350.56 (treqind e tete mije e treqind e pesedhjete pike pesedhjete e gjashte) Euro.**

**4-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 4,500 m2 dhe me siperfaqe ndertese 1,535 m2 me numer pasurie 28/69 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.431 date 21.06.2013 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 18 Faqe 142 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 884,800 (teteqind e tetedhjete e kater mije e teteqind) Euro.**

**Ankandi do te zhvillohet ne date 12.06.2019 ne oren 16:00 prane zyres se shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk me Permbarues Gjyqesor Privat Admir Beqiri te ndodhur ne adresen Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.**



PKSHA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**"PRODHIME KARBONIKE" SH.A.**
**(Carbon Plant Imp.&Exp. Co)**
Nr. 73 Prot , Dt. 17/05/2019

Adresa :
Zona Industriale Bradashesh
Elbasan EL 3000
Tel: + 355 54 255 562
Tel/ Fax. + 355 583 226 244
E-mail info@carbonplant.com
web: www.carbonplant.com
Kapitali 217.392.150 leke
NIPT J62903303 L / Kodi Fiskal 802528

**N J O F T I M**

Bazuar ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008, njoftojme mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise me kete rend dite:
1. Miratimi i pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2018 dhe i rezultatit financiar.
2. Miratimi i Programit te zhvillimit per vitin 2019.
3. Emerimi i eksperteve kontabel te regjistruar per auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2019.
4. Te tjera:
a) Rinovimi dhe miratimi i ODT.
b) Shtyrja e afatit per administratorin
c) Shtyrja e afatit per Keshillin e Administrimit.
5. Miratimi i projekt rezolutave te ndryshme.
Mbledhja do te behet ne ambientet e selise se shoqerise me date 10 Qershor 2019, ora 11.30
Dokumentat e nevojshme per mbledhjen e asamblese jane vene ne dispozicion ne seline e shoqerise.

Adresa jone eshte :
Prodhime Karbonike sha, (Zona Industriale).
Elbasan, Albania
Tel & Fax: +355 542 55 562
Fax : +355 583 26 244
E-mail: info@carbonplant.com

DREJTORI I PERGJITHSHEM
BASHKIM PROGRI

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, shpërndahen tapitë dhe paratë e kompensimit

# VKM, lista me 2 mijë pronarët që marrin tapitë

## Kompensohen pronarët, 230 milionë lekë për 510 përfitues

Ornela Manjani

Rreth 2 mijë persona që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapitë për truallin. Ndërkohë, 510 pronarëve të cilëve u është zënë toka nga këto ndërtime do të kompensohen. Vlera e parave që do të përndahet për përfituesit është rreth 230 milionë lekë. Vendimi është marrë këtë të mërkurë nga qeveria dhe do të zbatohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila do të pajisë me certifikatë pronësie 2 mijë përfituesit në 12 qarqe të vendit. Ndërkohë që fondi prej 230 milionë lekësh do të shpërndahet nga Agjencia e Trajtimit të Pronave. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e tapive dhe sipërfaqet takuese për secilin dhe listën me pronarët që kompensohen së bashku me shumën e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

**VENDIMI**

Qeveria miratoi kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve përfituese për 1 205 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre, ku përfitojnë rreth 2 mijë familje. Përfituesit janë në qarkun Berat, Qarkun Elbasan, Qarkun Durrës, Qarkun Tiranë, Qarkun Fier, Shkodër, Vlorë, Gjirokastër, Kukës dhe Korçë. Sipas vendimit të qeverisë, masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas ZVRPP-së është 33 964,81 m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 229 092 338 lekë. Qeveria ngarkon zyrat vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Kavajë dhe Kukës të regjistrojnë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to, në përputhje me përcaktimet e pikave 15 e 16, të vendimit nr.1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara".

| Nr. rendor | Të dhënat e Pasurisë | | | Sipërf aqj a për |
|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 208 | VANGJEL | SELMAN | BALLIU | 500 |
| 209 | FERIT | SALI | KULLA | 498.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 210 | ARBEN | ABDULLA | HAZIZI | 222.5 |
| 211 | HANIFE | XHEMAL | MALOKU | 303.6 |
| 212 | DRITA | ADEM | BARDHI | 131.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 213 | SHKELQI | QAZIM | TASHI | 306.3 |
| 214 | SABRI | ALI | BODURRI | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 215 | LEONA | XHELAL | GJYLA | 191.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 216 | ERINDA | PËRPARIM | DURI | 216.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 217 | PALI | KOSTË | DEDJA | 24.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 218 | FERDINAN | RIZA | QEFA | 244.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 219 | RRAPU | DAUT | DANA | 12.7 |
| 220 | MARGARI | NAIL | SULA | 24 |
| 221 | NEKI | HABIB | ALI | 327.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 222 | IZET | SALI | MEÇO | 239.7 |
| 223 | ERMIRA | ABAZ | ZELA | 246.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 224 | ARBEN | BASHKIM | KUMINJA | 307.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 225 | ILIR | HEKUR | HOXHA | 276 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 226 | SERAFI | MIHAL | TOSKA | 72.5 |
| 227 | KRISTA | KOST | ÇIPI | 174.7 |
| | ALEKSAN | MIHAL | ÇIPI | |
| 228 | ROZINA | KOSTANDIN | SHABANLLAR | 416.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 229 | GRAMO | MERSIN | BAJRAMI | 367.8 |
| 230 | HYQME | FAIK | AHMATI | 304.8 |
| 231 | PETRIT | SHEFQET | AHMATI | 308.7 |
| 232 | BUJAR | SELIM | SOLLAKU | 203.7 |
| | VJOLLC | RAMAZAN | SOLLAKU | |
| 233 | ERVIS | NOSI | KUQJA | 339 |
| 234 | TAQI | JOSIF | OGA | 296.1 |
| | FATMIR | TAQI | OGA | |
| 235 | ASTRIT | SHEFQET | ÇEKREZI | 242.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 236 | DILAVE | RAMAZAN | SHARRA | 303 |
| 237 | FADIL | AQIF | MUSTA | 106.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 241 | ARJAN | SABRI | HASA | 41 |
| 242 | NEVIN | JORDAN | BEZHANI | 261.8 |
| 243 | DILAVE | REFAT | KRYEMADHI | 340.5 |
| 244 | DRITA | HAMIT | SULKJA | 28.7 |
| 245 | DHIMITRA | FOTO | DUKA | 193.2 |
| 246 | THANA | LONIDHA | ÇARAHOSHI | 107.2 |
| 247 | ARBEN | ASLLAN | KADRIU | 64.5 |
| 248 | ELMAS | ISLAM | PISHA | 84.8 |
| | VALBO | HASAN | PISHA | |
| 249 | ZENEL | RAMADAN | KADRIU | 187.8 |
| 250 | TAULA | DYLBER | TAFA | 33.5 |
| 251 | NADIRE | REXHEP | MYRTEZA | 25.7 |
| 252 | DAFINA | VELADIN | CERRIKU | 249 |
| 253 | GJERGJI | THOMA | KANAÇO | 243 |
| 254 | ÇELNIK | HEKURAN | PAPRI | 15.5 |
| 255 | VASFI | JAUP | ISUFI | 82.3 |
| 256 | SULEJMA | QAZIM | BOÇI | 242.1 |
| 257 | THOMA | SOTIR | GUXHO | 27.3 |
| | SENA | MIHAL | GUXHO | |
| 258 | SPIRO | JORGJI | SGURI | 237.4 |
| 259 | BASHKI | NEZIR | ÇEKREZI | 314.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 260 | ALIM | SHEME | SULI | 259.2 |
| 261 | ZENEL | MESUT | LEKA | 464.1 |
| 262 | LULEZI | MURAT | MUÇA | 500 |
| 263 | EMILJANO | QANI | KUMRIJA | 247.7 |
| 264 | SHEFQE | HAXHI | XHARDJA | 291.3 |
| 265 | GËZIM | SAMI | XHARDJA | 285.3 |
| 266 | SAMI | METI | XHARDJA | 500 |
| 267 | GENTJA | SHEFQET | XHARDJA | 241.5 |
| 268 | XHEMA | SELMAN | XHARDA | 393 |
| 269 | SOKOL | HAXHI | XHARDJA | 327.6 |
| 270 | EDMIR | SHEFQET | XHARDJA | 307.8 |
| 271 | BESIM | FAIK | XHARDJA | 332.1 |
| 272 | BLEDAR | SEFER | BODURRI | 342 |
| 273 | ALTIN | SABRI | BODURRI | 366.6 |
| 274 | TAHIR | ALI | BODURRI | 324 |
| | ARMAND | TAHIR | BODURRI | |
| 275 | BARDH | NEVRUS | BOÇI | 385.3 |
| 276 | BLEDAR | NEVRUS | BOÇI | 319.5 |
| 277 | FLAMU | QERIM | LLESHI | 310.2 |
| 278 | FLAMU | QERIM | LLESHI | 111 |
| 279 | DURIM | OSMAN | BITRI | 202.8 |
| 280 | OSMAN | ALI | BITRI | 274.8 |
| 281 | RUDIN | ISMAIL | TAFA | 390.6 |
| 282 | RYZHDI | XHEMALI | GURABARDHI | 321.9 |
| 283 | SOKOL | RYZHDI | GURABARDHI | 359.31 |
| 284 | ASTRIT | RYZHDI | GURABARDHI | 257.1 |
| 285 | ELVAN | PETRIT | GJYLA | 242.4 |
| | PETRIT | OSMAN | GJYLA | |
| 286 | AGRON | MEHEDI | GJYLA | 393.9 |
| 287 | SELIM | HAXHI | KUMURIJA | 303 |
| 288 | RAMIZ | HAXHI | KUMURIJA | 402.6 |
| 289 | HYSEN | SHERIF | KUMURIA | 301.8 |
| 290 | YZEIR | SHERIF | KUMURIJA | 387.7 |
| 291 | QANI | SEJDIN | MUÇA | 264.9 |
| 292 | NAZIF | ISLAM | PREÇI | 372.9 |
| 293 | RAJMOND | SPIRO | SHATI | 317.4 |
| 294 | DEMIR | SULO | MURATI | 446.1 |
| 295 | ÇLIRIM | JONUZ | TASHI | 209.1 |
| 296 | LUAN | SHAIP | TASHI | 429.6 |
| 297 | STEFAN | VENEMIN | DERVISHI | 412.8 |
| 298 | EDVIN | SKËNDER | AVDIU | 320.4 |
| 299 | KADRI | CANE | KRYEMADHI | 303.6 |
| 300 | VASIL | ASLLAN | SHKIRA | 318.9 |
| 301 | ARDJA | RAMAZAN | TOROMANI | 267.6 |
| 302 | RAMAZ | SHABAN | MIRAKA | 278.4 |
| 303 | FLAMU | DEMIR | BUZDRA | 316.5 |
| 304 | GENC | OSMAN | GJYLA | 388.8 |
| 305 | KASTRIO | SOTIR | PANXHI | 308.1 |
| 306 | PETRIT | TAMAZAN | TOROMANI | 193.5 |
| 307 | ARTUR | PETRIT | MURATI | 367.6 |
| 308 | ILIR | ZALO | KRYEMADHI | 238.5 |
| 309 | DYLAV | XHEMALI | GURABARDHI | 481.8 |
| 310 | BENI | SPIRO | PANXHI | 336.9 |
| 311 | XHEVIT | HAZIZ | MURATI | 261.3 |
| 312 | HAZIS | NOVRUZ | MURATI | 220.8 |
| 313 | SOKOL | DEMIR | TAFA | 500 |
| 314 | LUFTAR | XHEMAL | MUÇA | 337.2 |
| 315 | BUJAR | KOÇI | DUZHA | 248.1 |
| 316 | KLEDIS | HYSEN | ÇEKREZI | 327.3 |
| 317 | SAIMIR | XHEMALI | LLESHI | 241.5 |
| 318 | BUJAR | XHEMAL | LLESHI | 431.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 319 | REXHEP | ISMAIL | BALLA | 457.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 320 | PELLUM | ADEM | ALLIU | 276 |
| 321 | PELLUM | ADEM | ALLIU | 127.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 322 | FERIT | RAHMAN | LLUSHI | 148.5 |
| 323 | XHEVDET | VELI | QOSJA | 295 |
| 324 | BEDRI | VELI | QOSJA | 286.2 |
| 325 | NAIM | TAHIR | GURRA | 430.5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 326 | XHEVAHI | DESTAN | BRAZHDA | 500 |
| 327 | SAJMIR | XHEZAR | MEMA | 500 |
| 328 | SHEFKI | MEHMET | DOSKU | 353.4 |
| 329 | EMRO | ISMAIL | DOSKU | 324 |
| 330 | OLSI | ISAK | DOSKU | 81.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| | IDAJET | SAMI | ÇOTA | |
| | SAMI | ISAK | ÇOTA | |
| | SAZAN | SAMI | ÇOTA | |
| 331 | VLADIMIR | SAMI | ÇOTA | 352.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 332 | XHEVAHI | RUZHDI | LUZI | 225.6 |
| 333 | SHABAN | HAZIZ | HIDRI | 120 |
| 334 | SHKËLQI | QAZIM | KOJKU | 319.2 |
| 335 | FERDINAN | LIMAN | RUÇI | 85.9 |
| | ANDON | HAKI | SOLLAKU | |
| | ADRIAN | MAHMUT | LEKA | |
| 336 | SKENDER | SHAZIMAN | KARRIQI | 14.2 |
| 337 | FERIT | ALI | MANA | 330.4 |
| 338 | SHPËTIM | MUHARREM | BAJRAMI | 10.6 |
| | RIFAT | MURAT | QOSHKU | |
| | LUTFIJE | IBRAHIM | BAHITI | |
| | SHEFKI | FERAT | BAHITI | |
| 339 | IRIDION | SHEFKI | BAHITI | 34.9 |
| 340 | JANI | IMER | TANUSHI | 44.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 341 | GËZIM | GANI | TERZIU | 439.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 342 | ARTAN | ABEDIN | MURATI | 257.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 343 | NAZMI | ISMAIL | XHABLI | 457.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 344 | AGIM | MEVLUT | KOLGJOKA | 337.5 |
| 345 | NEZIR | DILAVER | KOLGJOKA | 304.2 |
| QARKU ELBASAN , ZVRPP GRAMSH , ZONA | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 347 | ALI | MEHMET | BOSI | 230.4 |
| 348 | SAMI | KASËM | KLLOGJRI | 322.5 |
| 349 | DËFRIM | BEXHET | ZITO | 193 |
| 350 | LORENC | FERDINAN | DERVISHI | 341 |
| | FERDINAN | RIZA | DERVISHI | |
| 351 | GJERGJI | ASTRIT | DERVISHI | 302.7 |
| | ALDO | ASTRIT | DERVISHI | |
| 352 | MYFTAR | MERSIN | ZITO | 58 |
| 353 | NEVRUS | RAMAZAN | HOXHOLLI | 75 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 354 | ARJAN | NEVZAT | SPAHO | 353.4 |
| 355 | SEFEDIN | HAMIT | ZERO | 348.9 |
| 356 | GENCI | SHAHIN | SKÔNDERI | 164.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 357 | PANDELI | MEHMET | HOXHA | 286.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 358 | ARDJAN | ZENEL | TOÇKA | 249.3 |
| 359 | NAIM | KAJO | BAHUSHI | 149.4 |
| 360 | SHABAN | IDRIS | BALLA | 479.7 |
| 361 | VASIL | GURI | BALLA | 340.4 |
| 362 | PAJTIM | ZENEL | ÇOLLARI | 474.8 |
| 363 | LUAN | ZEKMAN | TOÇKA | 348.9 |
| 364 | NIKOLL | VIKTOR | TOÇKA | 330 |
| 365 | SHPËTI | VELI | QESOLLI | 308.4 |
| 366 | GJERGJI | NEXHAT | QESOLLI | 314.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 367 | VALBO | AGIM | KURTI | 182 |
| 368 | PRANVER | RIZA | ISLAMI | 9.2 |
| 369 | LUAN | QAZIM | KOÇI | 271 |
| 370 | MARTIN | DRITAN | ZHUPANI | 248.2 |
| 371 | RRUZH | ADEM | ASLLANI | 368.1 |
| 372 | AGIM | RAMO | BEGA | 376.6 |
| 373 | XHEMA | QAMIL | LIÇI | 180.5 |
| | INDRIT | XHEMAL | LIÇI | |
| 374 | ARTIAN | SAMI | MEÇO | 413.1 |
| | GENTJAN | BEXHET | MEÇO | |
| 375 | HALIL | QAZIM | RRANGA | 167.2 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 377 | AGIM | DILAVER | MARA | 115.1 |
| 378 | KASTRIO | MERFAT | BEGOLLARI | 299.2 |
| 379 | DAFINA | PETRO | ISUFAJ | 28.8 |
| 380 | BARDH | QERIM | GJONA | 87.2 |
| | AVDI | ISMAIL | HOXHA | |
| | SAIMIR | AVDI | HOXHA | |
| 381 | GENTIA | AVDI | HOXHA | 317 |
| 382 | ALI | HAMIT | FAIKU | 84.3 |
| 383 | KLAJDI | XHAFERR | MUSAI | 272.7 |
| 384 | FAIK | KADRI | RAMAZANI | 372.9 |
| 385 | ABEDIN | SELIM | KOVAÇI | 45 |
| 386 | IBRAHIM | ABDURRAH | PERLEPI | 157.8 |
| 387 | GENTIA | SABRI | MANI | 298.8 |
| 388 | MEHEDI | VELI | HOXHA | 261.6 |
| 389 | GANI | SAMI | GERLICA | 396 |
| 390 | AGIM | SAMI | GERLICA | 489 |
| 391 | AGRON | SAMI | GERLICA | 279.3 |
| 392 | REFIK | SHKURT | HASALLA | 41.8 |
| 393 | GEZIM | VANGJEL | OGA | 177.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 394 | SADIK | QAMIL | BARDHI | 313.2 |
| 395 | NAIM | IBRAHIM | BARDHI | 218.4 |
| 396 | BESIM | IBRAHIM | BARDHI | 469.2 |
| 397 | ILIR | IBRAHIM | HUSHI | 245.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 398 | AGIM | QAZIM | SAMURRI | 69 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 399 | MANUSH | IBRAHIM | KARAJ | 421.8 |
| 400 | MYSLIM | IBRAHIM | ISAKU | 355.2 |
| 401 | SOTIR | OSMAN | BURRAJ | 345 |
| 402 | ISLAM | MAHMUT | BICA | 420.3 |
| 403 | KUJTIM | MAKSUT | KARAJ | 401.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 404 | AGRON | ISMAIL | BALA | 199.5 |
| 405 | MEHDI | ISMAIL | BALA | 222.2 |
| 406 | ISMAIL | OSMAN | ZEQIRI | 312 |
| 407 | NADIRE | AQIF | SALLA | 449.1 |
| 408 | XHELAL | RRAP | CANGOJA | 500 |
| 409 | SHEFQET | JONUZ | QOSHKU | 225.7 |
| 410 | SEIT | HAZIZ | QOKU | 209 |
| | HAZIZ | SEFEDIN | QOKU | |
| 411 | ISMET | REFAT | SHABANI | 354 |
| 412 | FATMIR | HAJDAR | SALLA | 236.7 |
| 413 | XHEMAL | SELIM | ZELLI | 409.4 |
| 414 | SADI | BEHEXHET | MALOKU | 296.7 |
| | XHEMILE | FETAH | BARDHI | |
| | ANDREA | ADEM | BARDHI | |
| | RIGERS | ADEM | BARDHI | |
| 415 | DRITA | ADEM | BARDHI | 500 |
| 416 | QEMAL | QAZIM | RAMA | 367.2 |
| 417 | ASTRIT | RAMAZAN | DOPESHI | 297.3 |
| 418 | KLODIA | NAZMI | SEJDINI | 305.4 |
| 419 | ILIR | LIMAN | DAPESHI | 302.4 |
| 420 | AGIM | QAZIM | SAMURRI | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 421 | BASHKI | SEAT | KAMBERI | 11.55 |
| | NADIRE | REXHEP | KAMBERI | |
| 422 | GANI | RAHAMAZA | HAKA | 100.3 |
| | FATMIR | GANI | HAKA | |
| 423 | JANAQ | SPIRO | KRISTAQI | 67.4 |
| 424 | RAMAZ | ABAS | SHTYLLA | 9 |
| 425 | NAZIF | VELI | ZEQIRI | 243.1 |
| | ELIFE | SULEJMAN | ZEQIRI | |
| 426 | PLLUMB | ZYLYF | XHEBEXHIU | 200 |
| 427 | ALBERT | SABRI | ALLANI | 148.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 428 | FLOREN | RAMAZAN | QOKU | 142.9 |
| 429 | ALDION | ARBEN | ÇELA | 296.4 |
| 430 | DURIM | RAMAZAN | QOKU | 150.5 |
| 431 | ÇLIRIM | XHEVIT | BALLIU | 328.8 |
| 432 | BLERIM | AGIM | DEBROVA | 304.3 |
| 433 | SHERIF | HAMIT | DRAZHI | 321.1 |
| 434 | NESHAT | FAIK | KURTI | 96 |
| 435 | FATIME | MEHMET | LALA | 410.4 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 436 | HAKI | DAUT | LULI | 150 |
| 437 | VENEMI | PRENI | QOSJA | 192.6 |
| 438 | MUSTA | DAUT | LULI | 240 |
| 439 | NEXHMIJE | MEDI | ELEZI | 313.95 |
| 440 | SHERIF | MUSA | STAFA | 324.6 |
| 441 | IBRAHIM | ABDI | SALLA | 316.2 |
| 442 | ISMET | HAJDAR | ZAJAKU | 346.2 |
| 443 | ERJON | YZEIR | BRAHO | 173.3 |
| 444 | ISMAIL | MUSA | SKURA | 331.2 |
| 445 | LIMAN | DESTAN | LALA | 91 |
| 446 | QEMAL | JONUS | STAFA | 298.5 |
| | BASHKI | JONUS | STAFA | |
| 447 | MELADI | REFAT | BEQO | 364.2 |
| | IRJAD | REFAT | BEQO | |
| 448 | THOMA | JOSIF | MUÇA | 56.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| 449 | MIKEL | ARBEN | MISHA | 126.4 |
| 450 | ALFRED | SHEFIT | MUSTA | 221.1 |
| 451 | NAZMI | HILMI | MANA | 289.8 |
| 452 | SKËNDE | MYSLIM | MUÇA | 113.1 |
| 453 | SELIME | MUSA | GJOKA | 269.4 |
| 454 | GENTJA | NAIM | PALI | 285 |
| 455 | NAIM | JASHAR | PALI | 356.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA | | | | |
| | VJOLLC | RUSTEM | ÇELANJI | |
| | LAVDIM | SHABAN | SHABANI | |
| | BESNIK | QEMAL | SHABANI | |
| 456 | ARTUR | PETRIT | ÇULLHAJ | 46.4 |
| 457 | QEMAL | QAZIM | FILJA | 500 |
| 458 | TAHIR | MAKSUT | ÇELA | 165.8 |
| | DRITA | MEHMET | ÇELA | |
| 459 | LEONIDH | ILIA | TRUSHI | 274 |
| 460 | ZIJA | NURI | DAUTI | 395.1 |
| 461 | MITHAT | DALIP | PISHA | 344.4 |
| 462 | ARDJA | NOZE | KUME | 230.5 |
| 463 | MIKEL | RAMAZAN | KUME | 107.7 |
| 464 | ETMONT | RAMAZAN | PAJA | 237.6 |
| 465 | ORNEL | RUSHIT | ÇELIKU | 297.3 |
| | FABJAN | RUSHIT | CERRI | |
| 466 | ZAK | MARK | HALILI | 274.5 |
| 467 | RRAHMA | SHEFQET | PEPA | 355.5 |
| 468 | XHEVAHI | SHEFQET | PEPA | 321.3 |
| 469 | NEZIR | IDRIZ | PAJA | 153.4 |
| 470 | REFAT | BAJRAM | PISHA | 205.4 |
| 471 | VANGJEL | PETRO | NDREÇKA | 24.1 |
| 472 | AQIF | LIMON | DISHA | 344.4 |
| | MYZEJEN | SHAQIR | DISHA | |
| 473 | TOMORR | VEIZ | DERSTILA | 52.4 |
| 474 | VASILLO | NASHO | BELLO | 344.9 |
| 475 | BUKUROS | IBRAHIM | MEÇANI | 127.2 |
| 476 | SAIMIR | HYSNI | BARDHI | 18 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 477 | PERPARIM | ISUF | SKODI | 66.2 |
| 478 | HEKURAN | SEIT | POÇI | 166.9 |
| | BUKURIE | MUSA | POÇI | |
| 479 | FAIK | IMER | HALILI | 283.7 |
| 480 | PETRIT | MEHMET | CURA | 327.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 481 | SKENDER | MYFTAR | ALLIU | 366.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 482 | BUJAR | DAUT | ÇEPI | 250.7 |
| | DILE | MEHMET | ÇEPI | |
| 483 | ARIF | SHEFQET | HYSA | 323.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 484 | MUSTAFA | HYSEN | TOÇI | 164.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 485 | KUJTIM | ABEDIN | MURATI | 311.4 |
| 486 | BEHAR | JAHO | TERZIU | 135.7 |
| 487 | ISMAIL | HASAN | RRUMBULLAK | 342 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 488 | IDRIZ | FAIK | BALLA | 387.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |
| 489 | SALI | IMER | BUFI | 276.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA | | | | |

(vijon)







Përfaqësues të universitetit "Luarasi" gjatë aktivitetit në Shkollën Teknike Ekonomike

## Zv.ministrja e Arsimit, Lori Haxhiu: Shkollat profesionale garantojnë sukses

# "Dita e dyerve të hapura", Shkolla Teknike Ekonomike bashkëpunim me "Luarasin"

## *Prof.dr Ethem Ruka: Çfarë mund t'u ofrojmë nxënësve tuaj*

Voltiza Duro





Rektori i "Luarasit", prof. dr. Ethem Ruka në Shkollën Teknike Ekonomike

Roli i arsimit profesional është vendimtar në ndërtimin e një shoqërie me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e kulturor. Mbi të gjitha, tregu i punës kërkon çdo ditë e më shumë persona të aftë në profesione të ndryshme. Shkolla Teknike Ekonomike në Tiranë është një ndër shkollat profesionale që ofron mundësi të shumta zgjedhjesh për nxënësit. Në "Ditën e dyerve të hapura", zv.ministrja e Arsimit, Lori Haxhiu është rikthyer edhe njëherë në bankat e kësaj shkolle. "Kjo është një shkollë që në momentin që të hap dyert është e sigurt që merr maksimumin dhe do të kesh sukses edhe në të ardhmen", - tha zv.ministrja e Arsimit. Ndërkohë, drejtoresha e përgjithshme e Politikave të Arsimit Profesional, Silva Banushi, theksoi rëndësinë e këtij arsimimi. "Është formimi profesional, ai që kërkohet sot në tregun e punës. Çdokush e ka kuptuar që vende pune ka, por kërkohet arsimi i duhur", bëri me dije Banushi. Drejtoresha e Shkollës Teknike Ekonomike në Tiranë, Anila Nanaj Bani tha se ky institucion ka krijuar bashkëpunime të shumta me biznese të ndryshme, banka të nivelit të dytë e kompani sigurimesh. Ajo më tej ka vlerësuar edhe bashkëpunimin me universitetin "Luarasi". "Kjo shkollë sot është e hapur për të gjithë ata që sot janë kandidatë potencialë për të qenë nxënësit tanë në regjistrimet e vitit 2019-2020. Ne kemi bashkëpunime të mira me kompani të sigurimeve në Shqipëri. Kemi pasur gjithashtu bashkëpunim të mirë me universitetin 'Luarasi' përmes organizimit të disa 'workshop'-eve me mjaft vlerë për nxënësit tanë", theksoi drejtoresha e shkollës së mesme ekonomike. Rektori i "Luarasit", prof. dr. Ethem Ruka është shprehur i gatshëm për thellimin e bashkëpunimit me këtë shkollë të mesme, duke ofruar praktika për nxënësit në ambientet e universitetit. "Ne jemi vazhdues të kësaj shkolle, sepse te 'Luarasi' kemi Fakultetin Ekonomik, një nga fakultetet tona më të mira dhe jemi të gatshëm që të shtojmë raportet e universitetit me shkollën e mesme. Dhe kemi shumë për të bërë. Jemi të gatshëm që nxënësit tuaj të vijnë te 'Luarasi' për të bërë praktikë, për të marrë pjesë në nisma të ndryshme, siç ishte ajo e fundit për inovacionin në fushën e ekonomisë", nënvizoi prof.dr. Ethem Ruka. Dekani i Fakultetit Ekonomik te "Luarasi", Mateo Spaho e vlerësoi maksimalisht Shkollën e Mesme Teknike Ekonomike për idetë dhe projektet që nxënësit e kësaj të fundit realizojnë. "Një shkollë me shumë histori, që ka rrënjë të thella. Gjithashtu, një shkollë që merret me ekonomi dhe përgatit ata që janë teknikë të mesëm të ekonomisë. Ne të universitetit 'Luarasi' që përgatisim teknikët e lartë kemi absolutisht një lidhje preferenciale me këtë shkollë fantastike, plot me projekte dhe ide", tha Spaho.

### LORI HAXHIU

Shkolla Teknike Ekonomike në Tiranë është një ndër shkollat profesionale që ofron mundësi të shumta zgjedhjesh për nxënësit. Në "Ditën e dyerve të hapura", zv.ministrja e Arsimit, Lori Haxhiu është rikthyer edhe njëherë në bankat e kësaj shkolle. "Kjo është një shkollë që në momentin që të hap dyert është e sigurt që merr maksimumin dhe do të kesh sukses edhe në të ardhmen", - tha zv.ministrja e Arsimit.

### PROF. DR. ETHEM RUKA

"Ne jemi vazhdues të kësaj shkolle, sepse te 'Luarasi' kemi Fakultetin Ekonomik, një nga fakultetet tona më të mira dhe jemi të gatshëm që të shtojmë raportet e universitetit me shkollën e mesme. Jemi të gatshëm që nxënësit tuaj të vijnë te 'Luarasi' për të bërë praktikë, për të marrë pjesë në nisma të ndryshme, siç ishte ajo e fundit për inovacionin në fushën e ekonomisë".

BOTIMI

# ANISA MARKARIAN

## Një epokë brenda një romani, "15 ditë prilli"

Nga Luan Rama

Në kopertinën e romanit të saj të parë, Anisa Markarian veç të tjerash shkruan: "... Jam banorja e dashuruar në qytetin-bunker.

Jam intelektualja e asfiksuar nga despotizmi ideologjik.

Jam artistja e dënuar për evazion ëndrrash.

Shtyjeni portën pa frikë"!...

... Dhe unë e shtyva portën dhe padyshim pa frikë, pasi e kam jetuar atë epokë, ashtu si dhe ajo. U riktheva 40 vjet më parë. Lexova librin, pashë afreskun e madh të një epoke, të një jete të jetuar në një vend totalitar. Rilexova dhe pashë ngjyrat e atij afresku hijerëndë, në tone të errëta, si në tablotë e fundit të Gojas "pinturanera", ku në të zezën gjeja prushe dhe ngjizje të së kuqes, dëshirat e fjetura, britma ngazëllimi në fshehtësi, pasi bota e njeriut jeton dhe në një hon tragjik. Një libër dëshmi, një përjetim i dhimbur, sa personal aq dhe kolektiv, me të njëjtin afresk të krijuar shumë vite me parë nga George Orwell në romanin e tij "Viti 1984". Po ato ndarje, nëndarje, zyra, dikastere, divizione, Zyra të Shkëmbimit të Dënimeve, Departamenti i Represioneve, i Dizifektimeve, i Endrrave, pse jo. Rigjeta hijet e njerëzve të njohur, miqtë të mi të burgosur, por të paqtë pas burgut, se çuditërisht ata janë më paqësorët dhe asnjëherë nuk i bien gjoksit, asnjëherë nuk u ka pëlqyer të ngjiten në skenë si heronj. Ata e dinë se në këtë jetë efemere ajo që ka rëndësi nuk është pushteti, por dashuria mes njerëzve dhe paqja.




*"Si i kujtoj unë orët e anatomisë në vitet 1970 si kineast"*

Anisa më kujtoi një skenë tjetër, atë të studimit të Anatomisë. Atëherë ishim të rinj, kineastë të sapo dalë nga shkolla. Kisha parë një tablo të Rembrandt, "Mësimi i Anatomisë" dhe meqë një mik student në mjekësi më kishte treguar rreth orëve të mësimit të Anatomisë njerëzore, bashkë me mikun tim Bashkim Hoxha, ashtu kureshtarë të dy, shkuam në spitalin e Tiranës. Duhej të ishte një shtator i fundit të viteve '70. Studentët sapo kishin ikur. Salla ishte bosh dhe diku pranë një lavamani, ne pamë jo thjesht një kufomë njeriu, çka ishte diku më tutje, në një nga tavolinat, por pikasëm një kokë të prerë me një të çarë, majtas me bisturi, si duket për të parë anatominë e kokës. Dhe pikëpyetja jonë e menjëhershme ishte se e kujt mund të ishte ajo kokë?... Atëherë thoshin se studimet e anatomisë në spitali bëheshin me njerëz të rrugëve pa familje që i gjenin të vdekur... Por më vonë, shumë vonë, do të mësonim se ato trupa nuk ishin vetëm të njerëzve pa njerëz, por dhe të atyre të dënuarve të zhdukur! Një imazh që nuk do mund të shuhej nga kujtimet tona.

Kjo skenë përshkruhet mjeshtërisht nga Anisa Markarian, si shumë tablo të romanit të saj, pasi ky roman është si një vijimësi tablosh të jetës shqiptare, si një lloj libri i madh me kapakë të rëndë, ku ne gjejmë jetën tonë; është një dëshmi, ku ndryshe nga dëshmia dokumentare ajo është letrare, një letërsi tashmë e lëvruar gjerësisht që nga Pasternaku, Solzhenicini etj., si dhe autorët e gjithë Lindjes europiane pas rënies së Murit të Berlinit, vazhduar me "Shakanë" e Kunderës, "Pallatin e ëndrrave" të Kadaresë dhe shumë e shumë të tjerëve. Kjo lloj letërsie në Lindjen europiane duket se është mbyllur disi, edhe pse letërsia padyshim do ti rikthehet sërish, por në Shqipëri, kjo po shkruhet është në krijim e sipër, krahas gjinisë dokumentare, e vlefshme për të plotësuar kuadrin historik. Sigurisht, bota shqiptare është parë këtu në tonet më të errëta të asaj kohe, paçka se marrëdhëniet njerëzore kishin një lloj humanizmi, jeta vazhdonte mes represionit, njerëzit kishin dashuritë e tyre, pra një mori ndjesish të bukura, të solidaritetit gjithashtu, që çuditërisht në një botë demokratike, në lirinë e plotë të individit nuk i gjen. Por kjo anë e dritës, mendoj se do të bëjë ndoshta një temë të re për letërsinë e kësaj autoreje.

Zëri i Anisa Markarian është një zë sa real aq dhe imagjinar, ku grotesku dhe sarkazma zënë një vend të rëndësishëm si në tablotë e "Kosheres së heronjve", që lidhen me krijimin e "Njeriut të Ri" dhe të heronjve, por edhe në përshkrimet e botës së largët të Urthit, që s'është gjë tjetër veçse bota e nëndheshme dhe e fshehtë e Burrelit apo Spaçit... Dhe padyshim, interesin më të madh, kjo botë e zgjon sot tek gjeneratat e reja që nuk e kanë jetuar një kohë të tillë. Zëri i Anisës tingëllon bukur dhe me neologjizmat e saj, me atë gjuhë plot sqimë, sa tokësore dhe shpesh në zhargone, aq dhe e kërkuar, e praruar, ku dhe një skenë e bukur erotike, ajo tregohet me një pasuri leksike të jashtëzakonshme. Mund ta lexoni si këtu në këto pak radhë...

"... Paraloja lëngëzore kishte marrë fund. Ishin ngacmuar, drithëruar, mikluar, torturuar. Ishin pikëtakuar. Kishte mbërritur çasti i puthitjes. Çasti kur kërkohet dëgjim (më saktë përgjim) dhe bindje e verbër. Përkushtim gjithëshqisor e disipline për të shijuar plotësisht njëri-tjetrin...

- Ida?

- Futu Vlad...

Krateri ishte bërë liqenth. Shëtiti bregut pa ngut. U mbush me frymë dhe mbylli sytë. Do të shkiste brenda magmës me një zhytje të ëmbël. Do të prekte bërthamën inkandeshente e do të ringjitej në sipërfaqe. Për t'u rizhytur më thellë, me një kredhje më apne. Pastaj do të ritërhiqej gjer në hyrje, por nuk do të dilte nga uji. Do të notonte zhytas. Gjithnjë e më thellë. Hovshëm! Do t'ia shtrydhte ijët me të dyja duart. Fort, fort, gjer në dhimbjen e bukur! Pastaj do të bënte durim sa të ndiente derdhjen me shkulme zjarri, për t'u fashitur edhe vetë i dehur, i mundur, i thërrmuar...

- Të dëshiroj... - pëshpëriti ajo, qepallërrëzuar.

Ç'priste më? Pse nuk po ndodhte ngjeshuria? Boshti i tultë ishte flashkur mu në prag të tunelit...".

Markarian është imagjinative pasi kjo vjen nga jeta dhe përvoja e saj në kinematografi. Aktorja e njohur, me syrin jo rrallë në kamera dikur (një nga personazhet që unë e kisha imagjinuar në skenarin e filmit "Vajzat me kordele të kuqe") apo me interpretimet e saj spikatëse në sheshin e xhirimit, metamorfozat e atij shpirti të njomë në jetën e personazheve, ka bërë që letërsia e saj të ndikohet shumë nga kinematografia dhe lënda e kondensuar e këtij romani, fare mirë mund të na jepte një ditë imazhet tronditëse të një filmi. "Botimet Çabej", kjo shtëpi botuese me shumë kërkesa, sqimë e përzgjedhje, çka e tregojnë botimet e mrekullueshme të derisotme sa shkencore aq dhe letrare, na e solli këtë roman për të pasuruar botën dhe imazhet e një kohe të shkuar dhe të domosdoshme për të njohur gjer në damarët e saj dhe skutat më të fshehta.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k** njofton Shpalljen e Ankandit të **I-rë**, për shitjen e pasurisë **ARE**, me sip. **1045 m²**, Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 319/24, Vol. 1, Faqe 220, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **836,000(tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) LEKË**.

Ankandi do të zhvillohet më datë **22.05.2019**, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k , në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

**NJOFTIM ANKANDI**

1. **Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k** njofton Shpalljen e Ankandit të III (Tretë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 496/386+3-N2, Vol. 52, Faqe 239, ndodhur në Linzë Dajt, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGLI" shpk identifikuar me NIPT J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **4,465,843 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet e tre) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **24.05.2019, ora 16:00,** pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k , në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDIT TE DYTE**

Më datë 06 qershor 2019 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e pasurive: a)nr.26/106+1-16, vol.51, fq.242, sip=72 m²; b) Njësi shërbimi nr.26/187-N8/2, vol.56, fq.121, sip=20m²; c) nr.26/187+1-9, vol 52, fq 58 (sip=110 m²); d)nr.26/106+1-25, vol 52, fq 1.
Çmimi fillestar (për pasuritë e lartpërmendura) për njësinë e shërbimit do të jetë 1120 euro/m², ndërsa për tre apartamentet do të jetë 252 euro/m²;
Pronat e lartpërmendura ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN"shpk (NUIS J97201218L)
P.s: Qytetarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet te jetë e derdhur në BKT, nr.llogarisë Saimir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA ).
Me adrese : Selia: prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Mobile: 06920 756 44, Phone/Fax: 052 22 6000. Web: <http://www.permbarues.al/> www.permbarues.al

PREMTIMET

# GJINUSHI:

# Akademia, partnere e qeverisë. Përgjegjësi për meritat e dështimet

Fatmira Nikolli

Kandidati i vetëm në garë për detyrën e kryetarit të Akademisë së Shkencave në zgjedhjet e 24 majit, Skënder Gjinushi, ka bërë publike platformën e tij. Në të, ai thotë se kërkon rritjen e reputacionit të këtij institucioni, përcaktimin e qartë të meritave dhe përgjegjësive të tij, si për dështimet e problemet, ashtu edhe për arritjet në fushën e shkencës e të kërkimit shkencor, në promovimin e tyre, për periudhat e suksesit, por edhe për periudhat dhe fazat e tranzicionit. "Institucioni duhet të kryejë misionin e tij, duke mos iu shmangur përgjegjësive, por edhe duke mos marrë mbi vete atë çfarë nuk i takon....", thotë Gjinushi e për shumëçka që nuk shkon ai vëren se "kjo trupë e zgjedhur ndër vite është reflektim i gjendjes, nivelit të standardeve të kërkim-studimit në vend". Kryetari i ardhshëm thekson se Akademia e Shkencave, "nuk shikohet si vetë problemi, sa herë që ndeshen të tilla në ecurinë dhe nivelin e kërkimit shkencor, por si partnerja kryesore e qeverisë dhe e shoqërisë për ringritjen e standardeve, për dhënien e rrugëzgjidhjeve, për evidentimin e shkaqeve, etj., pra ky duhet të jetë roli ynë parësor dhe kryesor në 4-vitet në vazhdim". "Chairman to be" thotë se shkenca shqiptare, sistemi ynë i kërkimit është në fazën e nevojës së një reforme rrënjësore. "Akademia e Shkencave do të kthehet nga institucioni që ishte nën presion për t'u reformuar, në institucionin që drejton dhe nxit reformimin e sistemit të shkencës dhe të vetë Akademisë, në institucionin që bën presionin e duhur në emër të trupës së kërkuesve, të mjedisit intelektual e të gjithë shoqërisë, për nevojat dhe drejtimet e reformës, jo vetëm me akte ligjore, por të shoqëruar me institute, qendra kërkimore shkencore të riorganizuara, me dhënie të statusit të merituar punonjësve të kërkimit dhe institucioneve kryesore të sistemit të kërkimit shkencor në vend", - shënon Gjinushi në platformë.

**PREMTIMET**

Gjinushi thotë se një prej efekteve pozitive të reformës së ndërmarrë është edhe rikthimi i legjitimitetit për shumë anëtarë të Akademisë së Shkencave, të atyre me më vlerë e me më shumë përvojë, të cilët kontributin kryesor në këtë Akademi e kanë dhënë në periudhën kur shoqëria nuk e baltoste, por krenohej me Akademinë e Shkencave. "Angazhimi ynë është që t'i jepet jetë parashikimit ligjor për përfshirjen si anëtarë komisioni edhe të kërkuesve, profesorëve, doktorëve jo 'Akademikë' në komisionet e Akademisë. Kjo përbën një përpjekje të qartë për hapje të Akademisë ndaj institucioneve kërkimore në vend, për ta kthyer atë në një qendër reale të debatit shkencor". Ai shprehet se reforma që "duam të realizojmë së bashku në këto 4 vitet e ardhshme hap Akademinë e Shkencave edhe drejt joanëtarëve, në kundërshtim kjo me përpjekjet e 'reformave' që mbyllnin dyert edhe për vetë anëtarët e saj". Sa i takon bashkëpunimit me akademitë e rajonit, Gjinushi thotë se është sfidë, hapja e Akademisë së Shkencave ndaj akademikëve dhe akademive të rajonit. "Realizimi i saj do të vendoste në një bazë më të shëndoshë e më ligjore, veçanërisht bashkëpunimin me Akademinë e Kosovës. Mbështetur në gjithë sa përmendëm më sipër, angazhimi ynë dhe ambicia e përbashkët është që mbledhjet e përgjithshme vjetore të Akademisë së Shkencave, një herë në 2 vjet të shoqërohen nga një 'samit i albanologëve' për të evidentuar, përcaktuar, vlerësuar arritjet në fushën e albanologjisë, për gjuhën, origjinën, historinë e identitetin shqiptar me synimin kryesor: përcaktimin e drejtimeve kryesore të kërkim-studimit në këto fusha, përfshirë dhe përgatitjen e specialistëve të rinj, mbështetjen me fonde, etj. Çdo dy vjet 'samiti' i kërkuesve e studiuesve në fushat e tjera të kërkimit së bashku me anëtarët korrespondentë e dhjetëra kërkues të suksesshëm kudo që janë, për të evidentuar gjendjen, vlerësuar arritjet, kontribuuesit kryesorë dhe drejtimet e së ardhmes".



Skënder Gjinushi

*Del platforma e kandidatëve të vetëm për postet në Akademinë e Shkencave*

**MESAZHET PËR TË TJERË**

Ai nuk lë jashtë platformës edhe mesazhe për të tjerë dhe shqetësime të hershme. "Qëllimi dhe synimi nuk është kthimi formal në vitet e lavdisë së Akademisë 'me institute', që i tremben disa, që çuditërisht tmerrohen nga ideja e ngritjes së qendrave elitare pranë Akademisë së Shkencave dhe nuk tmerrohen nga dështimi i shumë qendrave elitare, sapo u shkëputën prej Akademisë së Shkencave", thotë Gjinushi. Ai thekson se Akademia e Shkencave nuk mund të luajë rolin e misionin e saj, pa vendosur kontakte ligjore komunikimi me Këshillin e Ministrave, Komisionin e Kuvendit dhe organet politikëbërëse të shkencës në vend. Ligji i ri parashikon format e këtij bashkëpunimi. "Kam besimin se së bashku me ju, së bashku me prurjet e reja dhe me bashkëpunëtorët e jashtëm të rinj, që mundëson reforma, ne mund t'i realizojmë ato. Në qoftë se ju keni të njëjtin besim, do të jetë një nder e përgjegjësi për Ne shprehja e këtij besimi me votën tuaj" e mbyll ai platformën e tij.

## HUMB VULA E 1640-ËS? ARKIVI: BËHET FJALË PËR VULË NË DOKUMENT, JO FIZIKE

Një vulë e vitit 1640 prej datës 10 maj nuk dihet se ku gjendet. Në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, denoncimi për humbjen e saj është denoncuar nga vetë drejtori Ardit Bido dhe mësohet se arkivi nuk ka dijeni për vendndodhjen e vulës prej datës 10 maj 2019. Ka aludime se ditën e zhdukjes së saj, kamerat në arkiv kanë qenë të fikura. Policia ka marrë në pyetje disa prej punonjësve të DPA-së, ndërsa prokuroria është në pritje të një akti ekspertimi, pas ekzaminimit që i është bërë fermanit të Manastirit të Kamenës në Drejtorinë e Policisë Shkencore.

**REAGIMI I DPA-SË**

Puna në arkiv na tregon se ka edhe raste kur dokumenti nuk gjendet në vendin e vet, por është keqvendosur në njësinë e ruajtjes, në kuti, apo në raft. Në raste edhe më të rralla, kemi konstatuar se dokumentet mungojnë. Koha kur dokumentet humbnin në arkiv dhe zbulohej pas muajsh apo vitesh e mbahej vetëm një akt konstatimi administrativ, siç janë dhjetëra raste, kanë marrë fund një herë e mirë. Sistemet e sotme të sigurisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave garantojnë që çdo parregullsi të zbulohet brenda një dite pune për të marrë masa të menjëhershme. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dëshiron të njoftojë opinionin publik, duke marrë shkas nga disa përmendje edhe në media, se kemi konstatuar, gjatë punës sonë, mungesën e një fragmenti përbërës të një dokumenti. Fragmenti që mungon është një vulë plumbi e vitit 1640, që ndodhej bashkëlidhur me një dokument që, në terminologjinë e fushës, emërtohet sigjil. Nuk kemi të bëjmë me vulë fizike moderne. Pjesa më e rëndësishme, vetë dokumenti në pergamenë, është i paprekur. Ngjarja po hetohet nga strukturat e specializuara. Në përfundim të këtyre hetimeve, do të njoftoheni mbi çdo eventualitet.



MILOSAO

E DIEL
19 Maj
2019

# Si i njoha Enver Hoxhën dhe Mehmet Shehun



NGA DAVID SMILEY

McLean u kthye pas disa ditësh dhe ne patëm vizitën e parë nga shtabi - shtabi i përgjithshëm i LNÇ, në të cilin dy udhëheqësit kryesorë qenë Mehmet Shehu dhe Enver Hoxha. Mehmet Shehu ishte i shkurtër, i ashpër, i ngrysur, fytyrëzbehtë rreth të tridhjetave që nuk i qeshte buza përveç me fatkeqësitë e të tjerëve. Ai fliste mirë anglisht ishte shumë i zoti dhe kishte njohuri ushtarake më shumë se çdo shqiptar tjetër. Pas mbarimit të një shkolle amerikane në Tiranë, ai pati ndjekur një kolegj ushtarak në Napoli, nga ku u përjashtua për veprimtari komuniste; bëri një kurs oficerësh në Tiranë dhe shkoi në Spanjë në vitin 1938, atje iu bashkua Brigadës Internacionale 'Garibaldi' dhe u bë zëvendëskomandant i batalionit të katërt. Kur brigada u tërhoq në Francë në vitin 1939, ai u internua tre vjet. Kur u lirua u kthye në Shqipëri ku iu bashkua lëvizjes partizane, pas pak kohësh u bë anëtar i Komitetit të Partisë Komuniste për krahinën e Vlorës. Në kohën që ne e takuam qe komisar për të gjitha forcat partizane të zonës.

Atij i kishte dalë nami për trimëri, egërsi, mizori, mburrej se me duart e tij u kishte prerë grykën shtatëdhjetë karabinierëve italianë që i kishte zënë robër. Unë u afrova me të në fillim, sepse si ushtarë ne kishim diçka të përbashkët; por ai nuk përpiqej aspak ta fshihte se nuk i pëlqenin gjërat britanike dhe lidhjet e mia me të u prishën. Në njërin nga takimet tona me shtabin, ai bëri akuza të çmendura kundër nesh, duke u betuar se ne ia kishim dhënë Ballit Kombëtar të gjitha armët që ishin hedhur në Shqipëri, duke mos lënë asnjë për partizanët. Si përgjigje nxora nga çanta ime një tufë letrash me listat e armëve që ua pata dorëzuar partizanëve bashkangjitur me firmat e marrjes në dorëzim; i lexova me zë të lartë përballë shtabit, përballë shqetësimit dhe tërbimit të Shehut dhe ai nuk ma fali kurrë këtë. Më vonë, kur u formua Brigada e Parë Partizane, ai e tregoi veten si një dukje e poshtër e burracakërisë siç ende nuk e kisha parë, aty shkëmbeva fjalët e fundit me Shehun dhe nuk ishin fjalë mirësjelljeje. Pas luftës u bë kryeministër i Shqipërisë dhe e mbajti këtë pozitë derisa u raportua se kishte bërë vetëvrasje më 1981.

→Vijon në faqen 14




# Papa me origjinë shqiptare Klementi XI dhe ikona e famshme e Shën Mërisë në qytetin Çenstohova të Polonisë

NGA LEONARD ZISSI

Në pjesën perëndimore të qytetit Çenstohova (Cz?stochowa) që ndodhet në jug të Polonisë, është një kodër 293 metra e lartë mbi niveline detit, që quhet Jasna Gura (Jasna Góra). Në këtë kodër , që polakët e konsiderojnë si Sankturium (vend i shenjtë), mbi themelet e një kishe të vjetër që quhej "Virgjëresha e Bamirësisë Shumë e Shenjta Shën Mëri", nga Urdhëri katolik i Paulinëve që erdhën në Poloni nga Hungaria, në vitin 1382 u ndërtua një Manastir, bashkë me komplekset e tij. Në këtë Manastir ndodhen shumë vepra arti të bukura kishtare, por më e rëndësishme është Ikona e Shën Mërisë që mban Jezu Krishtin në krahun e majtë. Për shkak të ngjyrës bronz të errët të fytyrës së Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit, si rrjedhojë e përdorimit të vernikëve gjatë restaurimeve të shpeshte që i janë bërë Ikonës ndër vite, ajo ndryshe quhet "Madonna e Zezë".

→Vijon në faqen 16

{ Në këtë numër: DAVID SMILEY, FERIDE PAPLEKA, MIRA MEKSI PER MOIKOM ZEQON, LEONARD ZISSI, ARBEN MEKSI, IN MEMORIAM DHIMITER LIGORI, SOKRAT PASKALI DHE MELITA VJERDHA... }

Redaktor: Ben Andoni; Grafika Artan Buca. 388

# K
## KUJTIME

*Smiley është një nga ushtarakët anglezë që ka qëndruar më shumë në vendin tonë, por që jetoi deri në vitet e fundit dhe pa të gjithë metamorfozën e Shqipërisë*



Islam Radovicka, Spiro Moisiu, Enver Hoxha, britaniku Lik, Omer Nishani, Myslym Peza dhe Miladin Popoviçi

# Detyra në Shqipëri

NGA DAVID SMILEY

*Vijon nga faqja 13*

Enver Hoxha qe një karakter plotësisht i ndryshëm, një burrë trupmadh i shëndetshëm me një dhënie dore të flashkët. Ai nuk qe njeri ushtarak ndonëse kishte kërkesa ushtarake, por ishte më shoqërues se sa Shehu dhe fliste me ne një frëngjishte të rrjedhshme. Atij ndoshta nuk i pëlqenim, por në fund të fundit i fshihte ndjenjat e tij, ndërsa me Shehun e ndieje armiqësinë.

Hoxha ishte rreth tridhjetë e pesë vjeç. Ai pati mësuar në shkollën fillore të Gjirokastrës, liceun në Korçë dhe më tej në Universitetin Monpelje të Francës, të cilin u detyrua ta lerë sepse u rrëzua në provimet. Ai vajti në Bruksel dhe Paris për të studiuar drejtësi, por nuk u diplomua kurrë dhe u kthye në Shqipëri që të bëhej mësues i frëngjishtes në Gjimnazin e Shtetit në Tiranë; më vonë u transferua në Liceun e Korçës po si mësues i gjuhës frënge. Ne gjithnjë e njihnim si 'Profesor', Enver Hoxhës me sa dukej i shkonte ky titull prej mësimdhënies. Ai e ndërpreu punën e mësuesit në vitin 1940, për të drejtuar një dyqan cigaresh në Tiranë, e cila u bë një bërthamë komuniste dhe vendtakimi i elementëve kundër shtetit; pas themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare më 1941, ai u bë sekretar i përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë, me sa dukej këtë post mbante edhe në kohën kur e takuam për herë të parë.

Unë shkoja mirë me Hoxhën, madje edhe pse ai qe i prirur të kërcënonte me fjalë e të humbiste durimin me mbledhjet tona që nuk kishin të mbaruar. Kisha kënaqësinë ta ngacmoja rreth politikave të tij dhe sa më shumë propagandë komuniste të ushtronte ai tek unë aq më shumë kapitalist, imperialist dhe djathtist bëhesha. Njëherë, ne po qëndronim përballë një harte lufte të botës, ndërsa ai po më fliste pa pushim se si do të dëshironte ta shihte botën pas luftës, natyrisht të gjithë botën e donte komuniste. Duke u kthyer nga unë më tha, 'Si do të dëshironit ta shihnit botën, Monsieur le Captaine?'; të cilës iu përgjigja, 'do të dëshiroja ta shihja këtë hartë të ngjyrosur të gjithën në të kuqe, por jo atë lloj të kuqe që mendoni ju.' Ai u duk i çoroditur, por e lashë le ta vriste mendjen. Hoxha e kishte shumë ndjenjën e humorit dhe pas një gote me raki bëhej gazmor dhe zbavitës, në kundërti me shokun e tij Mehmet Shehu,- pozicion që e mban ende.

Ndërsa ndodheshim në Shtyllë lidhjet me Skënder Dinen u tendosën, sepse oficerët tanë rezerviste na raportuan se ai po përpiqej t'u nguliste atyre propagandën komuniste; pas një zënke të ashpër me McLean, ai iku për të mos u kthyer më kurrë. Në vend të tij LNÇ caktoi si nëpunës të ndërlidhjes një djalë të ri të quajtur Fred Nosi. Ai ishte i nipi i Lef Nosit, mikut të zonjës Hasluck dhe ishte arsimuar në një kolegj amerikan në Tiranë drejtuar nga Harry T. Fultz, ndoshta ai ka qenë amerikani më i njohur dhe më i dashur nga ata që kanë qenë në Shqipëri. Nosi fliste mirë anglisht dhe ne e përdornim si përkthyes në të shumtën e rasteve, ndonëse mjaft i këndshëm, e dinim se ishte komunist i bindur dhe si i autorizuar i LNÇ qe spiuni midis nesh që raportonte veprimet dhe takimet tona.



Enver Hoxha

Nexhip Vinçani më pati dhënë një listë të çetave të tij, me emrat e udhëheqësve të tyre, numrin dhe armët përkatëse. Nga këto çeta një numër partizanësh qenë përzgjedhur të vinin tek ne për t'u stërvitur, pas stërvitjes ne u jepnim edhe më shumë armë. Rastësisht këto çeta të përziera formuan Brigadën e Parë Partizane. Çeta e parë që mbërriti ishte ajo e Petrit Dumes, me të cilin unë shkoja mirë, sepse ai qe i ri, entuziast dhe i mprehtë për të mësuar. Ndërsa Duffy, Jones dhe Jenkins i stërvitnin për minat dhe çmontimet, McLean dhe unë i stërvitnim në armët më të rënda si mortajat 81 mm dhe pushkët 20 dhe 47 mm.

Rreth kësaj kohe mora vesh se italianët ndodheshin në Voskopojë, kështu u nisa më këmbë disa kilometra për të parë se ç'farë po ngjiste, isha i shoqëruar nga një dezertor italian i Forcave Ajrore, i cili i qe bashkuar Shtabit tonë Qendror. Kur arritëm e gjetëm qytetin në flakë, ndërkohë që po tërhiqeshin italianët i vunë zjarrin dhe përmendej se kjo ishte e pesëmbëdhjeta herë në historinë e tij. Italianët nuk hasën në kundërshtime dhe partizanët, të cilët qenë atje ishin tërhequr pa shtënë një pushkë. Kur e takova Vinçanin në qytet e pyeta përse nuk luftuan partizanët; ai u përgjigj se batalioni i tij 'ishte duke bërë një lëvizje për t'i marrë krahët armikut dhe t'ia priste rrugën' këto fjalë nuk i besova. Ishte e qartë se ata ia kishin mbathur dhe unë u hodha disi në sulm se batalioni i tij nuk ishte batalion por një bandë guerilase e mallkuar dhe sa më shpejt që ta ndalte qenien e tij si gjeneral në vend të një drejtuesi gueril aq më mirë do të ishte; ai dukej i ligështuar dhe u ndamë keq me njëri tjetrin.



Mehmet shehu

**Shkëputur nga libri "Detyra në Shqipëri"**

***Shqipëroi nga anglishtja: Meri Lalaj***



# E
## EPISTOLAR

NGA MIRA MEKSI

I dashur Moikom,

Kur lexoja librin tënd "Deti Kanibal" përnjëherë dhe pas tij " Plagosja e Kujtesës" të shkrova,- që vargjet e tyre po i shijoja shumë,- nga pak çdo ditë, me gllënjka-vargje, njëlloj,- siç shijohet një verë e çmuar.

Ashtu siç i lexoj përherë vargjet e tua, dehem lehtë me to,- ndonëse bëj kujdes të mos lexoj njëherit më tepër,- se 20 - 30 syresh ( marrëzi bën njeriu shumë i dehur) - dhe ngjitem në të tjera lartësi të Ekzitencës,- në të tjera dimensione sipërane,- që Kozmosi yt Poetik krijon.

Por nuk po të shkruaj për to.

Nuk po të shkruaj për romanin e Julia Krisevës "Meurtre à Byzance " ,-që më sygjerove pikerisht ti dhe vetem ti- ta lexoj,- pasi të ishte kujtuar,- kur lexove novelën time " Pa zemër në kraharor " dhe më shkrove:

" U zhyta në leximin marramendës ,i zotëruar nga idea e udhëtimit a e fluturimit në një shumësi labirintesh.

Mira e dashur, nuk është tregim,por shpalosje,- më shumë një bërthamë romani ,-një Fantazmagori Spanjolle dhe e Botës Prekolumbiane,- një prerje rrathësh e realiteteve dhe mitologjive.

Teksti yt letrar është gjithashtu një Ekzotikë dhe Shqetësim Universal! "

Dhe ditë më pas ,- kur po kuroheshe per Leucemine në Greqi,- më dërgove tekstin:

"MJEKË,MJEKË ... PA ZEMËR NË KRAHËROR!

Teksti yt!

Të jesh "një trëandafil pa kopësht".

Të pish mijra dolli pilquepijen e bardhë te actekëve!

Në vend të vrisnin Frida Kahlo-n vranë Trockin! Ah,kafka e madhe prej sheqeri e Fuentes!!

Ah,guri mistik i jadës!

Ah, QUETZALCOATL-I, Gjarpëri me Pendë !

Të jesh rishtarja e Erosit te actekëve-duke mos qenë!

Teatër kukullash druri që bëhen fëmijë prej mishi dhe gjaku të Colodit të jashtëzakonshëm-sepse Burotinoja është vëllai i vërtetë i Lizës në Botën e Cudirave.

Gjatë qëndrimit në Greqi një ditë shkova në Eleusina,tek tempujt e riteve të Demetrës,të Persefonit, të Kores dhe të Teleforit, të Mistereve Eulisiane.

Aty ishte një shpellë,e mbiquajtur si e Plutonit,ku dikur kishte gjarpërinj të shenjtë si hyjni të nëntokës, ktonikevëllezër virtualë te Gjarpërit me Pendë të actekëve.

Aty përjetova disa çaste plot dhimbje,mbase tërë amëshiminsepse kjo shpellë konsiderohej

*Dy autorët e njohur të letërsisë sonë po shkëmbejnë një vlerësim përmes shkëmbimit klasik, që ne po e botojmë tek "Milosao". Këtë vit është 70-vjetori i autorit të njohur dhe me këtë rast një sërë autorësh po shkëmbejnë mesazhe vlerësimi me të...*



# Letër për letërsinë e Moikomit

## Për Moikomin dhe letërsinë e tij

Nuk po të shkruaj për Borges-in, mjeshtrin tonë, plakun dinak, që te "Shifra" thotë se ai po i lexon fjalët e mia, po i shpik ato.
Apo të rikujtoj dhe komentet tona për vërtetësinë e këtyre fjalëve, ngase jetojmë në një të vetme botë;- as për " Pierre Menard-in" e tij dhe përgjigjen time letrare ndaj hamendësimit të Borges-it për një Pierre Menard të Dytë,- kur thura tregimin " Pierre Menard-i i Dytë"- me mendje te ti Moikom .
Sepse je ndër të paktët,ose i vetmi, që mund ta shijoje tregimin tim, pasi, mbi të gjitha, njihje " në majë të gishtave" atë,- që pat shkruar Borges-i, dhe se ai tregim- të pëlqente përmbi gjithë të tjerët- e shkruar prej tij.

si Porta e Hadit."
Nuk po të shkruaj për Borges-in, mjeshtrin tonë, plakun dinak, që te "Shifra" thotë se ai po i lexon fjalët e mia, po i shpik ato.
Apo te rikujtoj dhe komentet tona për vërtetësinë e këtyre fjalëve, ngase jetojmë në një të vetme botë;- as për " Pierre Menard-in" e tij dhe përgjigjen time letrare ndaj hamendësimit të Borges-it për një Pierre Menard të Dytë,- kur thura tregimin " Pierre Menard-i i Dytë"- me mendje te ti Moikom .
Sepse je ndër të paktët,ose i vetmi, që mund ta shijoje tregimin tim, pasi, mbi të gjitha, njihje " në majë të gishtave" atë,- që pat shkruar Borges-i, dhe se ai tregim- të pëlqente përmbi gjithë të tjerët- e shkruar prej tij.
Sepse do ta shijoje si askushsidomos palimsestin e Cervantes-it që imagjinova, ti që e ke palimsestin Specialitetin tënd.
Dhe më shkrove:

" E dashur MM.

Mos më thuaj se gërma e dyfishtë MM nuk lidhet me Menard-in e Borges-it.
Për të zhvarrosur dhe ringjallur ato Troja!
Sapo e lexova tregimin tënd në "Milosao".
Habitërisht më tingëlloi si Pierre Menard-i i Tretë.
Po Pierre Menard-i i Katërt?
Po i njëmijti?
Po Pierre Menard-i Zero?"
Nuk po të shkruaj për kartolinën ,-që Xhevo Spahiu të solli ty nga Parisi- dhe që mbante në frëngjisht dy vargjet e tua,- foton e së cilës ma dërgove: ishte një mol i bardhë ne qytetin Sette ,- te lindjes se Paul Valeryse,- përmbi të Kaltrën e detit,- me një Far në horizont.
Dhe vargjet e tua,- gdhendur me kripë të bardhë[- përmbi hapësirën e kaltër.
Të shkrova: "vargjet e tua mbajnë në krahë pluhur dritëhëne."
As për librin tënd " Eshtra Zodiaku",- nuk po të shkruaj, ku ndodhet një poezi që ma ke kushtuar mua,- vargjet e të cilit kanë absolutisht atributin- të të nxjerrin nga çdo lloj gjendje e keqe ,-ku mund të ndodhesh- dhe të bëjnë të ndihesh mirë,- në një botë me ngjyra, -përtej këtij realitetit të pashije të çdo dite...
Nuk po të shkruaj për Ernesto Sabaton,- shkrimtarin e madh të botës,- shkrimtarin tonë më të madh të të gjitha kohërave,- shkrimtarin që,- ashtu si ne ka stërgjysh- Skënderbeun.
Më kujtohen shpesh bisedat e vyera simultaniste me të- Sabaton ,- kur erdhi atë fundprill të viti i 1996 në Tiranë- për të marrë çmimin letrar- që i kishim përgatitur ne të gjithë,- me Fondacionin Velija në krye.
I kemi përmendur shpesh ne të dy fjalët e tij, amanetin e së ëmës arbëreshe, dëshirën përvëlonjëse të Princit të Letrave Argjenitinase,- për të mos ikur nga kjo botë pa parë malet e Shqipërisë...
Dhe përkrenarja e Skënderbeut në shkrimëtoren e Sabatos ne Santos Lugares, dhe Lulja Supernatyraliste ,-që pikturoi përmbi një pecetë letre- dhe na i la si kujtim një muzg,- në Dhomën e Verërave të Restorantit Piazza-s...
Nuk po të shkruaj as për Lukianin nga Samosata,- Rehtorin e shekullit të II, -i cili shfaqet në tregimin tim "Pasqyrat" për pasqyrën,- që mundi të këqyrte në Hënë.
Më shkrove se Lukiani konsiderohej si "Volteri i Antikitetit",- se e shkrimëtoren e Sabatos... se e kishe përmendur shpesh në krijimet e tua dhe, pasi komentuam gjatë librin e tij,- që porsa kisha lexuar " Histori të vërteta", më dërgove tregimin tënd të gjatë dhe të mrekullueshëm mbi Aleksandrin e Rremë,- të frymëzuar prej një subjekti të Lukianit nga Samosata.
Ishte koha kur kisha lexuar dy tregimet e tua,- po aq të pazakonta e magjike : " Enigma e Napolit" dhe " Andrea Manesi".
Nuk dua të ndalem as te labirintet,- të gjitha labirintet,- që kemi zënë ngoje gjatë komenteve tona pa fund.
Veçanërisht labirinti i Drakulës në tregimin tim te "Flutura mes gjinjve",- për të cilin më shkrove:
"E dashur Mira,
Brenda Mirës është labirinti i dyfishtë, i paraardhësve dhe pasardhësve të tu- mijëra nga e Kaluara dhe miljona nga e Ardhmja.
Tregimi yt për labirintin më kujtoi metaforën e futjes në një Perpeetum Mobile te një Thriller-i.

Kam kaluar shumë netë në Budapest .
Dhe kam shkruar:
" ...I mësova tërë Drakulat të jenë vegjetariane..."
Së fundi, nuk po të shkruaj as për Teutën e Ilirisë,- bisedat tona ndër vite për të,- dhe as për Misterin, vagullinë, mjergullën e dendur që mbulon vdekjen e saj,- ku hodha spirancën e lëndës,- që ngjizi kozmosin e nderlikuar, nebular, inkandeshent e " Mallkimi i Priftëreshave të Ilirisë"; -pikërisht në një vargun tënd intim,- enigmatik,- që hamendsonte vetvrasjen e saj,- kthimin e Saj në re...
Shpirti hyjnor Teutës, -i çliruar nga Njerëzorja,- Prijësi Shpirt i Ilirisë- dhe i Kohërave të Pafundme.
Po të shkruaj në të vërtet për PSALMET.
Jo ato të Davidit, Psalmet e Tua,- liturgjinë tënde poetike, këngët e Biblës së Shpirtit tënd.
Janë të magjishme.
Janë të jashtëzakonshme.
I lexoj dhe i rilexoj duke mbajtur frymën,- duke i dëgjuar herë në hebraishten parake të ëndrrës,- herë me muzikën e një instrumenti të lashtë me korda,- që Kohërat Moderne ia kanë fshirë emrin.
Më mbrojnë, më lartësojnë, më rrëfejnë udhën sipërane...

PSALMI YT 153.:

" O, Fjalë e vërtitshme mes hapësirave,
që je Trandafil i Erërave!

Pse mermeri i skalit heronjtë e vrarë mes baltës?

Ah, përfytyrimet janë kafshët,
që poeti i pjell në kopështin zoologjik të metaforave!

Gjaku ikën si zvarranik i lashtë,
i kuq në shkretëtirën blu!

Dhe dëbora na mbështjell
si qëndisje baroke dantellash
bërë nga gishtat e magjishëm të ajrit!

O, gramatika memece e pasqyrave!

Pse fytyrën e Arkilokut e kam maskë
dhe kam gjithashtu mbi supe
një pelerinë anemonash dhe kristalesh?

O, drita të pagjumësisë hyjnore!

Këta semaforë janë piktura dadaiste,
ose janë epikriza e sëmundjeve të mia
për mjekët e kozmosit!

Dhe qivuri prej Hëne e ka mbyllur
brenda qytetin.

Me lopata gjethesh
e hedh dheun e dritës mbi varrin e imazhit tim!
Mes sendeve të pavdekshme
pse isha (jam) kaq i vdekshëm?
I dashur Moikom,
ky është një Sistem i Ri planetar i Shkrimësisë, me figura letrare të pangjashme me asnjë figurë letrare të njohur më parë.
I quajnë si krahasime, metafora, metonimi..
. Por në të vërtetë janë diçka tjetër, Diçka e Tjetërllojtë, e fuqishme si gjaku, e prushtë si ndjenja.
Sistemi yt!
Janë figura gjeniale,- pse janë të pamundura,- nuk ekzistojnë as në realitetin e Jashtëëndrrës,- as në Imagjinatën njerëzore,- por kur i dëgjon në gjuhën e shenjtë aramaike,- apo shqipe,- Imagjinata vetë,- prej Magjepsjes,- pjell një Imagjinatë të përshtashme- për t'i asimiluar dhe shijuar.
Dhe atëherë ndjesitë njerëzore,- i kapërcejnë kufijtë që njohim,- dhe krijojnë ekstaza ndjesish,- të ngjashme me ato të perëndive...



MILOSAO

E diel 19 Maj 2019 GAZETA SHQIPTARE

K
KUJTESË

*Ikona ka përmasat 122x82 cm. dhe është shkruar mbi një dërrasë prej trungu bliri. Ajo paraqet Shën Mërinë të veshur me një fustan ngjyrë blu të errët, të mbuluar me një pelerinë, veshur me një astar të kuq, duke mbajtur në krahun e majtë Jezu Krishtin fëmijë. Pamjen e fytyrës ajo e drejton drejt qendrës, ndërsa gishtërinjtë e dorës së djathtë i drejton tek Jezu Krishti, si për të treguar se ai është burim shpëtimi. Nga ana e tij Jezu Krishti dorën e djathtë e drejton drejt qiellit si shenjë e bekimit nga Perëndia, ndërsa në dorën e majtë mban librin e Biblës.*

# Papa me origjinë shqiptare Klementi XI dhe ikona e famshme e Shën Mërisë në qytetin Çenstohova të Polonisë

NGA LEONARD ZISSI

*vijon nga faqja 13*

Ikona ka përmasat 122x82 cm. dhe është shkruar mbi një dërrasë prej trungu bliri. Ajo paraqet Shën Mërinë të veshur me një fustan ngjyrë blu të errët, të mbuluar me një pelerinë, veshur me një astar të kuq, duke mbajtur në krahun e majtë Jezu Krishtin fëmijë. Pamjen e fytyrës ajo e drejton drejt qendrës, ndërsa gjishtërinjtë e dorës sëdjathtë i drejton tek Jezu Krishti, si për të treguar se Ai është burim shpëtimi. Nga ana e tij Jezu Krishti dorën e djathtë e drejton drejt qiellit si shënjë e bekimit nga Perëndia, ndërsa në dorën e majtë mban librin e Biblës.

Në historinë e krishtërimit thuhet se, ikonat e para me fytyrën e Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit, janë shkruar (për ikonat thuhet se shkruhen dhe jo pikturohen) nga Shën Lluka Evangjelisti, që ka jetuar në shekullin I të erës sonë. Ai shkroi shtatëdhjetë ikona, dy prej të cilave thuhet se njera ndodhet në Bolonjë të Italisë ndërsa ikona e dytë ndodhej në Jeruzalem. Ushtarët e Kruqëzatave, në shekullin I, atë e gjetën të fshehur në një guvë dhe pastaj e vendosën në një kishëzë të Jeruzalemit.. Në vitin 326 atë e gjeti Shën Elena, nëna e Perandorit Konstadini i Madh (274-337) një prej perandorëve më të shquar të Perandorisë Romake, themeluesi i Konstandinopojës në vitin 330, të cilit ia dhuroi atë atij .Konstadini i Madh dëshironte që këtë Ikonë ta vendoste në ndonjë kishë të sapondërtuar në Konstandinopojë, por për shkak të luftrave që zhvilloheshin në atë kohë, kjo nuk u bë e mundur dhe Ikona u vendos në muret e qytetit, prej së cilës thuhet se armiqtë tmerroheshin dhe nuk mundën ta pushtonin atë. Kjo mund të konsiderohet "mrekullia" e parë e kësaj Ikone.

Më pas, Konstandini i Madh dëshëronte që Ikonën t'ia dhuronte një princi rus, por kjo nuk u realizua prej tij. Kronikat ruse thonë se Ikona, nga Konsandinopoja, filllimisht në vitin 1270, ka mbërritur në qytetin polak Lvov (sot ndodhet në territorin e Ukrainës) dhe pastaj në kështjellën e princit polak Vlladisllav Opolczyk, që ndodhej në qytetin Bellza, që edhe ai



Ikona e Shën Mërisë (Madonna e Zezë) në Manastirin e Çenstohovës

bënte pjesë në Mbretërinë Polake. Gjatë transportit të saj për në kryeqytetin e mbretërve polakë të Krakovit, kuajt e karrocës ndaluan në qytetin e Çenstohovës dhe nuk donin të lëviznin nga vendi. Legjenda thotë se kjo ishte shenjë e Shën Mërisë që ikona e saj donte të kishte shtëpinë e qëndrimit të përhershëm në Çenstohovë. Për këtë arësye, princi Opolczyk, më 11.VIII.1384, Ikonën ia dhuroi Urdhërit të Paulinëve që kishin ndërtuar kishën e tyre në kodrën në Jasna Gura, ku ndodhet edhe sot e kësaj dite.

Gjatë periudhave që pasuan, Ikona ka pasur historinë e saj. Ajo shpesh u grabit dhe u dëmtua, saqë në faqen e fytyrës së Shën Mërisë edhe sot e kësaj dite kanë mbetur shenjat e dy viaskave të shkaktuara nga goditjet me shpatë që i janë bërë asaj prej keqbërësve, kështu që ajo u nënshtruar restaurimeve të vazhdueshme. Restaurimi i parë është bërë pas dëmtimit të saj prej sektit të krishterëve të Husëve në vitin 1430, ku u tentua të zëvëndësohej ngjyra e zakonshme e fytyrës së Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit që përdorej në ikonat ortodokse bizantine, me ngjyrën e errët të vernikut. Kështu që ngjyrat e të dy fytyrave të tyre në Ikonë u zbehën në ngjyrën bronz të errët. Restaurimi i fundit është bërë në vitin 1948 ku u përdorën edhe rrezet rentgen. Analizat treguan se ngjyra e fytyrave të tyre fillimisht ishte e çelur dhe jo e ngjyrës bronz të errët të tanishme.

Rreth kësaj Ikone kanë ndodhur shumë ngjarje, por më e rëndësishmja, që i ka dhënë famë të madhe jo vetëm brenda Polonisë, por edhe jashtë saj, është ajo që ka ndodhur në vitin 1655, kur Suedia kish përgatitur një plan për të pushtuar Poloninë. Më 21 korrik të atij viti, ushtritë suedeze kaluan kufirin polak, duke shtënë shumë shpejt në dorë Varshavën, Poznanin dhe Krakovin. Në këto rrethana fisnikëria polake nuk donte të luftonte dhe kështu, pothuajse i gjithë vendi, ra në duart e suedezëve. Më 18 nëntor 1655, ushtria suedeze që numuronte tre mijë ushtarë, u ndodh para mureve të Jasna Guras dhe kërkoi që fortesa të dorëzohej. Por administratori i fortesës vendosi të mbrojë vendin e Shenjtë dhe të mos e dorëzonte atë, duke patur në dispozicion vetëm 170 ushtarë, 20 oficerë dhe 70 murgjër. Në krahasim me ushtrinë suedeze, forca mbrojtëse e fortesës së Jasna Gurës ishte rreth pesëmbëdhjetë herë më e vogël. Sulmin ndaj manastirit ata e konsideronin si fyerje të ndjenjave të tyre fetare, sepse kështu përdhunosej vendi i Shenjtë që Shën Mëria kish zgjedhur për të qëndruar. Prandaj, çdo ditë ata faleshin para Ikonës dhe i luteshin Shën Mërisë për t'i mbrojtur nga suedezët. Dhe kështu ndodhi. Luftimet zgjatën dyzet ditë dhe, për mrekulli, përfunduan me fitoren e kalorësve të Manastirit. Kjo fitore pati një rëndësi të jashtëzakonshme , jo vetëm fetare, por edhe politike, që konsiderohej se ishte arritur nëpërmjet ndërhyrjes dhe përkujdesit të Shën Mërisë për të mbrojtur vendin e vet të shenjtë. Që nga ky çast i gjithë vendi u ngrit në luftë dhe fitorja anoi nga ana

## Ikona bizantine e shndërruar

Ndonëse kjo ikonë me origjinë ortodokse bizantine është transformuar në ikonë katolike, nderohet dhe vlerësohet shumë edhe nga të krishterër ortodoksë, veçanërisht nga ata të Ukrainës, Biellorusisë dhe Rusisë. Në atë kohë, asaj i ishin bërë kopje, të cilat qarkullonin në vende të ndryshme të Europës.



Pjesa e brendshme e bazilikës së Manastirit të Shën Mërisë në qytetin Çenstohova të Polonisë



Papa me origjinë shqiptare Klementi XI (1649 - 1721)

## Kjo ikonë edhe në Shqipëri

Prifti jezuit polak Marçin Çeërminjski në veprën e tij të rëndësishme "SHQIPËRIA - përshkrime historike, etnografike,kulturore dhe fetare", botuar në vitin 1893 në Krakov, përkthyer në shqip dhe botuar në Tiranë vitin 2014, shkruan se një kopje e kësaj ikonë është sjellë edhe në Shqipëri në shekullin XIX nga një prift polak nga Galicia, e cila në atë periudhë ishte pushtuar nga Austria. Ajo ka qenë vendosur në altarin e kishës së Kallmetit prej peshkopit polak, Atë Françishek Mallçinjski, i cili në atë kohë shërbente në Lesh.

## ...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri nuk ishte se përbënte ndonjë gjë të veçantë. Por redaktori mendoi të ngrinte sipër një shkrim hipotetik për t'u larguar disi ndaj të zakonshmes së "Milosao". Autori Aristotel Mici, në mendimin e tij, referon se duke u mbështetur në veprën e Herodotit, na bëhet e qartë dhe e kuptueshme se Orakulli i Apolonisë për nga rëndësia vjen me një herë pas Orakullit të Dodonës dhe atij të Delfit. Kjo ide përftohet sidomos nga leximi i librit të Nëntë të veprës së Herodotit. Ngjarja, e cila na tregon autori, lidhet vetiu me Orakullin e
Apolonisë, që si Orakull i njohur, me siguri do t'i ketë pas dhënë dhe më shumë emër qytetit të lashtë! Në fakt, duket pak e tepruar dhe role të tilla duhet t'i marrin arkeologët, por nuk duhet harruar se autori duhet vlerësuar për besimin.
Luan Rama na kish sjell një tregim me titullin "Përtej Qafës së Botës", ku trajtohet një nga episodet më të dhimbshme të historisë sonë. Zhvendosja e çamëve është e trishtë por edhe e keqe dhe e trajtuar artistikisht nga autori. Autori ka një stil që e afron te Neorealizmi, por në këtë rast duhet që të ketë më shumë këmbë në letërsinë dokumentare. Në fakt, ka nevojë për disa thyerje.
Në këtë numër vijuam një shkrim kushtuar dokumenteve të Skënderbeut, që u botuan pas vdekjes së historianit Kristo Frashëri. "*Moria e këtyre burimeve historike dokumentare, me natyrë kancelareske, diplomatike, epistolare, kronikale në gjuhët latinisht, në italishten mesjetare, frëngjisht, spanjisht, osmanishte, në greqishten bizantine, sllavisht, në serbisht, deri në polonisht e gjermanisht, të dhëna në origjinal dhe të përkthyera në shqip, ndjekin kriterin tematik dhe janë radhitur në atë kronologjik*", shkroi i biri, që u përgatit për botimin e vyer.
Redaktori shtoi një argument lidhur me qasjen e letërsisë tonë ndaj bashkëkohësisë që për të duket vetëm në periudhën e romantizmit shqiptar, kohë kur shqiptarët kërkojnë në masë frymën e tyre kombëtare. Paçka se një pjesë e tyre u ushqyen nga larg kulturologjikisht, kjo kohë bashkë me periudhën e shkurtër ku ishte Migjeni treguan se letërsia jonë ka vlera. Ismail Kadare do të bëjë një inkursion gati vetanak duke hapur udhë në Letërsinë e Realizmit dhe duke prekur si askush parametra të lartë bashkëkohësie. Bash ato vlera që po mundohet sot të përcjellë zgjimi i një grupi autorësh, që kërkojnë një identitet brenda kaheve të reja të letërsisë. Leshanaku, mes tyre, po synon një nga çmimet më të larta poetike në botë..., shkroi ai. Për këtë shkrim, redaktori, pati një vërejtje nga një prej lexueseve më të rregullta të "Milosao" lidhur me qasjen e tij. "*Marin Barleti ka qenë në avangardë të bashkëkohësisë, bile ai vazhdon të jetë në bashkëkohësi. Këtë e tregon më së miri fakti që "Rrethimi i Shkodrës" u përkthye para dy vitesh edhe në gjermanisht, më saktë u pa e nevojshme të përkthehet (unë e kam recensionuar për Südostforschungen, revista kryesore në Gjermani për Evropën juglindore). Pastaj Fran Bardhi me apologjinë për Skënderbeun. De Rada ka qenë në bashkëkohësi, ai që ju e quani realizmi socialist ka qenë në avangardë të bashkëkohësisë (do ishte me vlerë të bëhen edhe studime për këtë). Sidoqoftë, i ashtuquajturi realizëm socialist, sepse sipas mendimit tim ky ishte thjesht një emërtim, e çoi Shqipërinë në Evropë*", shkroi ajo mes shumë gjërave të tjera. Redaktori e vlerëson shumë mendimin e saj. Ky numër i "Milosao" duhej të ishte më i mirë.

e polakëve, të cilën edhe sot e kësaj dite e konsiderojnë si një "Mrekulli" të dhuruar nga Shën Mëria. Për këtë arësye mbreti i Polonisë në atë kohë, Jan Kazhimiezhi I, në qershor të vitit 1656 pushtetin e vet mbretëror e dorëzoi tek Shën Mëria, duke e konsideruar Atë si Patronen dhe Mbretëreshën e Polonisë, vlerësim fetar që ka mbetur deri në ditët tona.

Duke parë rëndësinë e kësaj Ikone dhe pas vendosjes së paqes në Poloni me mbarimin e luftrave me Suedinë, në vitin 1711 filloi një fushatë për kurorëzimin me kurorën Papnore të Ikonës. Për këtë u shfrytëzua vizita e Nuncit Apostolik të Vatikanit të asaj kohe dhe, me miratimin e tij, ata iu drejtuan zyrtarisht Vatikanit për këtë çështje. Në vitin 1716 Papa i Vatikanit nënshkroi Aktin Kanonik të kurorëzimit të Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit me kurorën Papnore. Mbi bazën e këtij Akti, mbi kokën e Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit u vu kurora Papnore, ku ceremonia e këtij kurorëzimi u zhvillua më 8 shtator 1717, me pjesmarrjen e rreth 200 mijë besimtarëve polakë. Aktin e kurorëzimit të kësaj Ikone e nënshkroi Papa me origjinë shqiptare Klementi XI (1649-1721), duke u bërë kështu një pikë e rëndësishme takimi në historinë e marrëdhënieve midis dy popujve tanë, shqiptar dhe polak.

Një Mrekulli tjetër që polakët ia atribuojnë kësaj Ikone, është edhe fitoria e Ushtrisë Polake, nën komandën e Mareshallit Jozef Pillsudski ndaj ushtrisë bolshevike ruse në vitin 1920. Atë vit, kjo ushtri e krijuar mbas Revolucionit të Tetorit të vitit 1917, synonte të eksportonte revolucionin proletar në Gjermani, ku vepronte një lëvizje e fuqishme komuniste. Me këtë synim, ajo depërtoi deri në dyert e Varshavës, buzë lumit Vistula. Ajo ishte në numur shumë më të madh nga ushtria polake, e cila sapo ishte formuar mbas rifitimit të pavarësisë së Polonisë më 1 nëntor të vitit 1918. Ndodhur në këtë situatë të pafavorshme ushtarake, polakët i faleshin vazhdimisht Ikonës së Shën Mërisë në Manastirin e Çenstohovës dhe i luteshin asaj që ushtria polake të përzinte ushtritë bolshevike nga Polonia. Edhe në këtë rast ndodhi mrekullia. Ushtria polake zmbrapsi repartet bolshevike, çliroi Poloninë nga invazioni bolshevik dhe avancoi deri në dyerte Kievit. Me këtë fitore, ushtria polake shmangu avancimin e ushtrisë bolshevike drejt Europës Perëndimore, fatet e së cilës nuk dihet sesi do të ishin po të ndodhte okupimi i saj nga kjo ushtri. Edhe këtë mrekulli që ndodhi, polakët ia atribuojnë edhe faljeve para Ikonës së Shën Mërisë në manastirin e Jasna Gurës të Çenstohovës dhe e quajnë Mrekullia mbi lumin e Vistullës.

Ndonëse kjo Ikonë me origjinë ortodokse bizantine është transformuar në Ikonë katolike, nderohet dhe vlerësohet shumë edhe nga të krishterër ortodoksë, veçanërisht nga ata të Ukrainës, Biellorusisë dhe Rusisë. Në atë kohë, asaj i ishin bërë kopje, të cilat qarkullonin në vende të ndryshme të Europës. Siç shkruan prifti jezuit polak Marçin Çeërminjski në veprën e tij të rëndërsishme "SHQIPËRIA - përshkrime historike, etnografike,kulturore dhe fetare", botuar në vitin 1893 në Krakov, përkthyer në shqip dhe botuar në Tiranë vitin 2014, një kopje e e kësaj Ikone është sjellë edhe në Shqipëri në shekullin XIX nga një prift polak nga Galicia, e cila në atë periudhë ishte pushtuar nga Austria. Ajo ka qenë vendosur në altarin e kishës së Kallmetit prej peshkopit polak, Atë Françishek Mallçinjski, i cili në atë kohë shërbente në Lesh.

Ikona dhe Manastiri në Jasna Gura sot janë vende të shenjta jo vetëm për polakët, por edhe nga pelegrinë të shumtë dhe vizitorë që vijnë nga e gjithë bota. Ata bëjnë lutje të zakonshme, por edhe lutje për t'u shëruar nga sëmundje të ndryshme dhe për të patur fat në jetë. Me këtë rast ata japin edhe dhurata të ndryshme si gurrë të çmuar, prodhime prej ari dhe argjendi, të cilat i vendosin në vende të caktuara të Manastirit. Numuri i vizitorëve të përvitshëm arrin në mbi 4 deri 6 milionë vetë, prej të cilëve reth 300 mijë pelegrinë polakë vijnë në këmbë çdo vit nga e gjithë Polonia, një traditë e hershme kjo që nga shekulli XVIII. Sot ky pelegrinazh është nga më të mëdhenjtë në të gjithë botën. Shën Mëria e Çenstohovës festohet më 26 gusht të çdo viti.

Për lidhjen e ngushtë të kësaj Ikone me Papën me origjinë shqiptare, Klementin XI dhe për numurin e madh të pelegrinëve dhe vizitorëve që e vizitojnë atë nga e gjithë bota, do të ishte mirë që atyre t'u bëhej i njohur fakti se pikërisht ky Papë ka miratuar kurorëzimin e saj me kurorën Papnore të Shën Mërisë dhe Jezu Krishtit. Kjo do bënte shumë përshtypje pozitive tek të gjithë vizitorët, veçanërisht tek populli polak që është shumë besimtar katolik. Mendoj se Kisha Katolike në Shqipëri do të ishte mirë të kontaktonte me organet përkatëse të Kishës Katolike Polake dhe të mundësonte ekspozimin e portetit në pikturë të Papa Klementit XI, si dhuratë e saj për këtë Manastir.

L
LETËRSIA

*Autori përcjell një frymë filozofie në poemthën e tij të fundit...*

# PSE VALLË?

**NGA SOKRAT PASKALI**



*
femra ime më tha papritur
a ikim andej nga kanë ardhur të parët e tu
sa kg je e pyeta unë
58
do kem me vete 58 kg flori
çdo marrim atje
një tufë buzeqeshjesh ja vlen
ndoshta dashuri
kushedi

*
lulëzon natyra e bardha ndrin
është e shtunë ditë nusesh
pemët mbushur me lule si fustane të bardhë
do mbarsen si Maria dhe do lindin frutat
gjithë naze valaviten fletët
me gurgullimën e rrjedhës
e ndjejnë ekstazën time dhe qeshin
pemët lumi mali gryka madhështore
kishat e vjetra
dhe unë para supremes
vulhumbur mbetur
*
poshtë kapeles një fole merimange mendimesh
pse vallë
veriga të çelikta detajesh të kithta varen
ah flokët e rrallë
thashë mirë po shkoj andej nga kanë ardhur të parët e mi
gryka madhështore dhe lumi më priste
malet kruanin kokën e bardhë
me nje ton të çuditshëm më pyetën
hë erdhe Sokrat
malle nuk kishte
pse vallë
veriga të çelikta detajesh të kithta varen
njerëz të rrallë oh sa të rrallë
poshtë kapeles një fole merimange mendimesh
pse vallë
veriga të çelikta detajesh të kithta varen
njerëz të rrallë
i përshëndes dhe dua ti përqafoj
gjithmonë jam krenuar me ta
oh sa të mirë janë
Noli i lëvdonte dhe zonja Durham
se si po më duken sot
hiq lumin eh ç'ujra
hiq grykën oh ç'madhështi
gjelbërimi po ai që çmend kotësitë
të tjerat të ftohta
kaq të ftohta
pse vallë
poshtë kapeles një fole merimange mendimesh
pse vallë
veriga të çelikta detajesh të kithta varen
ah flokët e rrallë
thashë mirë po shkoj andej nga kanë ardhur të parët e mi
gryka madhështore dhe lumi me priste
malet krruanin kokën e bardhë
hë erdhe Sokrat
njerëz të rrallë oh sa të rrallë
hiq lumin eh ç'ujra
hiq grykën oh ç'madhështi
të tjerat ishin kaq të ftohta gri
shpirti m'u cingris këtu nuk ka asgjë pis
çdo gjë në vëndin e vet shkëlqen
e bukura e ëmbla e pastëra kudo
po njerëzit njerëzit ku janë
kanë ikur e ikin
pse vallë
njerëz të rrallë
i përshëndes dua ti përqafoj
gjithmonë jam krenuar me ta
oh sa të mirë janë
diçka i bën kaq të dlirë

*
lulëzon natyra e bardha ndrin
është e shtunë ditë nusesh
pemët mbushur me lule si fustane të bardhë
do mbarsen si Maria dhe do lindin frutat
gjithë naze valaviten fletët
me gurgullimën e rrjedhës
e ndjejnë ekstazën time dhe qeshin
pemët lumi mali gryka madhështore
kishat e vjetra
dhe unë para supremes
vulhumbur mbetur

*
gryka madhështore dhe lumi më priste
malet krruanin kokën e bardhë
me një ton të çuditshëm më pyetën
hë erdhe Sokrat
po malle nuk kishte
pse vallë

**30-31 mars 2019**

MILOSAO E diel 19 Maj 2019 GAZETA SHQIPTARE

K
KARIKATURA

# DHIMITËR LIGORI, artisti i madh dhe i heshtur i "Hostenit"

*Dhimitër Ligori nuk diti kurrë të bërtiste për vlerat e punës së tij, por çdo përgjigje e shoqëronte me një buzëqeshje të ndrojtur, sikur të ishte një njeri i zakonshëm dhe jo artisti, që ishte i mbathur me çmime ngado. Dhe kështu do të mbetet edhe për bashkëkohësit dhe ata që e njihnin, i thjeshtë dhe i qetë në bukurinë e artit të përshfaqur...*






NGA BEN ANDONI

Për shumë nga njerëz it që e njihnin punën e tij, kur i thoshe se Dhimitër Ligori është gjallë dhe për ditë ulet poshtë shtëpisë për një kafe nuk të besonin. E para e dinin se Ligori i përkiste një kohe krejt tjetër dhe e dyta i takonte një arti, që sot ka humbur shumë prej shkëlqimit të tij. Dhe, në këtë inerci duket shumë i largët. Autori i këtyre rreshtave e quajti dikur në "Historinë e Identitetit shqiptar përmes karikaturës" si të fundmin nga plejada e famshme në revistën "Hosteni". Dhe, kishte një arsye për këtë: E nisi krijimtarinë e tij, rreth shtatë dekada më parë, si bashkëpunëtor i jashtëm i revistës më të njohur humoristike në vend, kur ende merrej me pikturën. Njerëzit harrojnë se Dhimitër Ligori përpara se të ishte karikaturist ishte piktor i këndshëm dhe me shumë pretendime. Në një moment, kur profesor Buza (shpresojmë që nuk gabojmë) i sheh një punë të rastit do t'i kthehej direkt: Pse ke kaq humor dhe pse çdo ide e kthen në elementë humoristikë! Me sa duket, kishte qëlluar në shenjë. Në fakt, duhet të jesh një artist, profesor dhe dashamir, si Buza, të kuptosh rëndësinë e studentit që ke përbri. Ende pa i thënë këto fjalë, Dhimitrit i vinte si një vokacion i brendshëm humori dhe me të ndërtoi shumë fabula, kujtojmë fjalët e tij. Për dekada të tëra talentin e piktorës ai do ta bashkojë me sensin e thellë të idesë dhe do të prodhojë e do të prodhojë pa fund. Fillimisht, tematikave të përzgjedhura. Piktura i dha sensin e thellë të kompozicionit, por edhe përdorimin racional të ngjyrës, që ai e derdh ngado.

Shqipëria e Dhimitër Ligorit të lëbyr me imazhet e veta, ku problemet sociale, humane por edhe ato që lidhen me paradokset e kohës, kuptohet që mund të lejohen të kritikohen, zënë vend jo të pakët. E bukur është se shumë nga idetë e tij mund të përcillen dhe sot e kësaj dite në përballjen e thellë me korrupsionin por edhe shumë tema të tjera që na rrethojnë ngado. Kjo e bënte punën e këtij njeriu modest, që për një farë kohe drejtoi dhe një grup të artistëve të "Hostenit", të vlerësoheshin masivisht për mprehtësinë por edhe guximin e thjeshtë dhe pa zhurmë. Një nga punët e tij do të këtë kujtim të thellë dhe kjo lidhet me atë që kriza e sotme nuk do t'ia dijë për asgjë. Kuptohet se puna ka karakter ndërkombëtar dhe ai krizën e zgjedh me simbolikën e vdekjes që një qark fabrikash, që kanë barazi tek oxhaqet ajo u pret me kosën e vdekjes tymin, simbolin e punës. Kritika e tij prek edhe një nga karakteristikat më të mëdha që kemi, e që lidhet me ndërhyrjen, ku socializmi do të mbushej me raste të tilla dhe më keq akoma do të shkatërrohej prej vetë ndërhyrjes së njerëzve të saj.




Shqipëria e Ligorit ishte një Shqipëri që synonte veçse të sillte kritikën e bukur të përshfaqte dhe një vend me vlera që ti e kap me këndshmëri kur shikon atë që është pas punës së vet. Ashtu si ndodh në ligjin e pashkruar të Natyrës edhe për atë vdekja nuk do bënte pakt. Kishte kohë që e kishte lajmëruar dhe njeriu i artit i tutej si çdo krijesë, derisa në stacionin e fundit pakti ishte akut. Dhimitër Ligori la emrin e një artisti të mirë, me shumë pretendime dhe me standarde që duhet të vlerësohen nga bashkëkohësit. Kur vendi ynë të futet normalisht në shina normale dhe karikatura të këtë kritikën e saj reale, ai patjetër do jetë në vlerësimin e saj maksimal për frymën dhe gjetjet që bëri brenda kanoneve, që e detyronin të punonte. Dhimitër Ligori nuk diti kurrë të bërtiste për vlerat e punës së tij, por çdo përgjigje e shoqëronte me një buzëqeshje të ndrojtur, sikur të ishte një njeri i zakonshëm dhe jo artisti, që ishte i mbathur me çmime ngado. Dhe, kështu do të mbetet dhe për bashkëkohësit dhe ata që e njihnin: I thjeshtë dhe i qetë në bukurinë e artit të përshfaqur. (Milosao)

## Shqipëria e Dhimitër Ligorit

Shqipëria e Dhimitër Ligorit të lëbyr me imazhet e veta, ku problemet sociale, humane por edhe ato që lidhen me paradokset e kohës, kuptohet që mund të lejohen të kritikohen, zënë vend jo të pakët. E bukur është se shumë nga idetë e tij mund të përcillen dhe sot e kësaj dite në përballjen e thellë me korrupsionin, por edhe shumë tema të tjera që na rrethojnë ngado.



K

KARIKATURA

*Arben Meksi është një nga karikaturistët më të mirë shqiptarë dhe një nga ata artistë që ka vazhduar pa ndërprerje në dy kohë, duke përcjellë trashëgiminë e madhe të artistëve të kësaj gjinie kaq të dashur. Me stilin e vet, ai ka revolucionarizuar veten, duke përqafuar jo thjesht idetë por frymën më bashkëkohore, por edhe ka përcjellë mesazh që ky zhanër duhet të vazhdojë mbijetesën dhe të bëjë një vend në artin ndërkombëtar.*

# Të kërkosh objektin!

Arben Meksi është ndërfutur plotësisht në botën e artit karikaturik me karakteris tikat e tij më të mira. Në këtë punë, ku përshfaqet imazhi i një kupe, artisti përcjell simbolikën sesi kërkohet triumfi duke lënë pas vetes një objekt (Zgjidhur në formën e targetitku qëllohet) që shërben si vend ku drejtohet e gjithë cmira. Mbase përmes kësaj pune, ai ka bërë një metaforë kombëtare ose të themi ballkanike, ku çdo triumf ndiqet nga një problematikë jo e vogël. Interesant është zgjidhja sepse dora që e mban është pikërisht ajo që i jep mundësi të tjerëve të drejtojnë shigjetat e tyre të pamëshira.

E veçanta e punëve të Arben Meksit është hapësira filozofike, pikërisht ajo që i jep karakter ndërkombëtar dhe kërshëri ndjekjes së punëve të tij. Në disa nga punët e fundit shihet që karakteri shumë parcial i punëve tashmë i ka lënë vend elementëve pikturikë, një detaj që tregon se autori ka shumë më tepër kohë që merret me subjektin e tij por edhe është tejet më i fokusuar për objektivin e tij.

Arben Meksi është një nga karikaturistët më të mirë shqiptarë dhe një nga ata artistë që ka vazhduar pandërprerje në dy kohë, duke përcjellë trashëginë e madhe të artistëve të kësaj gjinie kaq të dashur. Me stilin e vet, ai ka revolucionarizuar veten, duke përqafuar jo thjesht idetë por frymën më bashkëkohore, por edhe ka përcjellë mesazh që ky zhanër duhet të vazhdojë mbijetesën dhe të bëjë një vend në artin ndërkombëtar.




T

TREGIM

*Ky tregim është marrë nga libri "Duart e Anës" (Tiranë, 1996). Ky tregim është paraqitur më 1986 dhe më 1988 në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", në një libër të titulluar "Mundja e vdekjes", i cili nuk e gjeti dritën e botimit. Është një histori kontradiktore dhe komike; recensat dhe vendimin e redaksisë i ruaj, mbase për t'i botuar një ditë si relikt, shkruan autorja...*

# "KUKULLA"

## *(Tregim retrospektiv)*

*Letërsia është një uzinë me kimera dhe makthe.*
*J. L. Borges*

NGA FERIDE PAPLEKA

Kur isha e vogël kisha mbledhur ca copëza kadifesh të mbetura nga një fustan që më patën qepur prindërit si dhuratë për Vitin e Ri. Ëndërroja shumë të bëja me to një kukull. Kukull të vërtetë nga ato që shiten sot në treg ende s'kisha parë, por i kisha parë shoqes sime një kukull të bërë vetë. Edhe ajo mbase e kishte parë te dikush tjetër. Ku ta dish? Ideja për të sajuar këto perëndesha të vogla është shumë e lashtë, ndoshta, që nga koha e qytetërimit sumero-akadian.

Me copërat e kadifes të palosura e të vendosura në një kuti tualeti të vjetruar që e kisha gjetur midis sendeve të nusërisë të nënës sime, vajta te shtëpia e Lilit - kështu e quanin shoqen time. Kishim biseduar për kukullën një ditë më parë dhe mezi prisnim të bëheshim bashkë. Do të doja ta riprodhoja këtu atë bisedë, nga e cila zë fill kjo ngjarje, që duke e shkruar, më duket sikur e zbuloj, por më pengon harresa.

Shtëpia e Lilit ishte nga ato ndërtesat tip njëkatëshe, me bodrum poshtë, me një verandë të vogël përpara, rrethuar me gjithfarë lulesh. Në verandë hyje duke ngjitur katër- pesë shkallë, me parete borë të bardha, ngaqë mami i Lilit i lyente vazhdimisht me gëlqere. Për të qenë sa më rehat, ne shkuam në një kthinë pas shtëpisë, në të cilën futeshe ose nga një derë e brendshme në korridor ose nga jashtë, përmes një deriçke, me dalje në kopsht. Aty në atë kthinë, mes asaj qetësie e ndieja veten gjithnjë të lirë. Ndoshta nga ajo liri fare e thjeshtë buronte ngazëllimi im i atyre çasteve. Shtëpia ime, ndryshe prej asaj kthine, ishte një apartament në një pallat dykatësh që sa futeshe brenda, kuptohet që do të mbyllje derën. Megjithëse isha dy pëllëmbë mbi dhe, kur kthehesha nga shtëpia e Lilit në apartamentin tonë, më dukej sikur më zihej fryma.

Iu vumë punës të dyja. Ishte një ditë pranvere nga ato që truri i fikson në kujtesë për mos t'i harruar. Shushurima e gjetheve të pemëve më bën sot të përfytyroj ekstazën e analfabetëve kur dëgjonin vargje nga Kantika e kantikave, ndërsa zogjtë që përplasnin flatrat të dehur nga rrezet e diellit, më shtyjnë të mendoj se mbase kanë qenë pikërisht zogjtë që qëndruan dikur mbi supet e Françisko de Asizit.

Lëviznim duart të heshtura e tërë seriozitet, siç veprohet nga të rriturit për një porosi që duhet mbaruar. Pre, qep e shqep deri sa kukulla mori formë. Ishte hera e parë që provoja të bëja një kukull. Më në fund i vendosa mbi flokët e sajuar prej një cope mëndafshi në ngjyrë të errët edhe diçka të shndritshme që shëmbëllente me një kapëse argjendi. Doli një kukull aq e përkryer, sa kur e vura përpara syve për ta soditur, m'u duk



se diçka më pëshpëriti. Unë iu përgjigja me ca fjalë të ëmbla, shijen parajsore të të cilave e kam të gjallë si sot. Vonë, kur u bëra nënë, duke mbajtur foshnjën time në duar, kam menduar se këtë çast tashmë e kisha përjetuar.

Kishte kaluar thuajse gjysma e ditës, kur u ngrita për të ikur. Mamaja më kishte thirrur dy-tri herë nga dritarja e një dhome që binte në vijë të pjerrët me derën e pasme të kthinës, për t'u siguruar që s'isha larguar, sepse e dinte që kur s'luaja jashtë, isha atje, dhe më kishte lënë të mbaroja më nge kukullën.

U ndava me Lilin - edhe ajo ishte si e shtangur nga bukuria e kukullës - dhe me shpirt krejt të mrekulluar, vrapova për në shtëpi. Kukullën e mbaja në duar. Teksa po i afrohesha shtëpisë - largësia ishte a s'ishte pesëdhjetë metra - më kapi një ankth që papritur ma rrëmbeu tërë lumturinë. Kalimi i viteve ma ka zbehur rrethanën e kësaj ndjesie, por pushtetin shtypës të atij çasti e kam të gdhendur në tru si shenja fatale e yllit në të cilin kemi lindur. Ankthi u kthye në një llahtari aq tronditëse, sa për një grimë here u ndala, pa ditur ku isha e ç'po bëja. Edhe të kisha qenë Judita me kokën e prerë të Holofernit ndër duar, nuk do të ngurosesha ashtu. Jam përpjekur ta shpjegoj atë transformim të beftë të gjendjes time psikike dhe lëmshi i mendimeve përherë më ngatërrohet. Isha aq e vogël, robinë e mikrouniversit tim fëmijëror, ku lulëzonte një jetë e dëlirë si te të gjitha vajzat e asaj moshe! Por historia jonë nuk nis në ne! Prej ç'kohë e prej ç'grimcë atomi, brofi nga gjaku im kompleksi se të mbash një kukull në duar, do të thotë të guxosh e të shkosh larg, të ngjitesh te e ardhmja jote e të shikosh pasqyrën tënde në fytyrën e një bebeje!? Është mendim tepër i çuditshëm për një vajzuckë që sapo ka mbushur pesë vjeçe. Unë as që e kisha menduar ndonjëherë këtë gjë, madje as se do të isha një ditë e rritur. Isha në moshën kur këto nocione nuk ekzistojnë, ngaqë fëmijët kanë një përfytyrim metafizik për kohën. Dikush tjetër që flinte në mua, pa dijeninë time u zgjua papritur.

Shtyva derën e shtëpisë, me kukullën në njërën dorë, e zhveshur nga çdo lloj emocioni të gëzueshëm dhe hyra në korridor si hije. Kur pashë tim atë në këmbë, në mes të kuzhinës, e humba fare. Ai më thirri që të më puthte, siç bënte kur ndodhej në raste tepër të rralla ditën në shtëpi. Me dridhma në shpirt, pa vetëdije, unë u futa në dhomën e gjumit, e prisha me të shpejtë kukullën dhe e çartallosur e hodha në një qoshe prapa dollapit. Golemi im dergjej tani i zhbërë në mënyrën më mizore.

Fare e papërqendruar pastaj iu afrova babit, e ftohtë, e zhveshur nga çdo ndjenjë. Zemra më rrihte aq fort, sa dëgjoja buçimat e saj në vesh e në tëmtha. Im atë u përkul në gjunjë, më mori pranë, më puthi sytë e më pa nga duart. "Ç'e bëre kukullën, shpirt?"- më pyeti. Unë e vështrova gjatë, pa mundur të nxirrja qoftë edhe një tingull. Dhe sytë m'u veshën nga dy pika të mëdha loti që rrinin gati për të rënë sa të ulja qepallat. "Vajza është e sëmurë", - i tha ai mëmës që po përgatiste drekën. Dhe duke më vënë dorën e tij të shtrenjtë mbi ballë, më ngriti hopa e më çoi në shtrat me pamje të trishtuar.

1986

# P

## POEZIA

*Autorja shkruan në gegnisht dhe lirizmi i saj i këndshëm i shkon disi shtendosjes së këtij numri të Milosao*



NGA MELITA VJERDHA

### 1.Rutinë enigma

A ke pasë ndonjëherë
nji boshllekaq plot
sa edhe në skutat ma të
ngjeshuna me u gjetë ?
Vdekje dëshirash
kujtime t'idhnueme
nevoja t'pashueme
grumbuj vuejtjesh
gjurmë vesesh
shpërdorim përshpëritjesh
mbeturina pasionesh ...
ashtu randuem prej boshllekut
me e ngrysë ditën me melankoli
të shueme ndër peizazhe ndodhishë
që bahen simbol.
E përfytyrimet me drejtue,
labirintet e brendshme të së nesërmes,
kur sotja si ngjet as të sotmes vetë.

### 2.Paradoks

Vjen nji kohë që i druhesh kohës,
asaj t'kalueme o t'pajetueme ,
stinë sëvdekun o andrres së mekun .
Sillesh përsillesh në kërkim
të nji asgjaje t'madhe
ku boshlleku i ma t'madhes asgja
ku shtin shumegja.
Vite, fate , mëkate
Ikonë zollush për nji dromcë liri
të asaj kafshate që merr e jep
frymë mitesh
zvarritun, plagosun
t'pasosun.
E ti endesh me ûnë e mbrujtjes
me njeri .
Shpresë në harresë
ushqy me të vetmin paradoks
të asgjasë.

### 3. Zymbyl

Nuk asht thjeshtë nji lule
Asht nji krijesë e brishtë
E dashurume marrëzisht me atë qe e ka
e s'e len prej saj me u nda.
Ndoshta nuk ka andrra ,
po andrren ta mbin në sy ,
kur aroma e saj puth në buzë të nesërmen
me kujtimin fluturak,
etjen e pa rrefyeme ,
shpresen e ngratë.
Derdh emnin në muzikë ujnash
Qendron mes shtegut
me sfondin e gjelbrimit delikat
e hijeshinë e ban portret të dashnisë pa mëkat .
Prej aty ku vjen origjina e dehjes
veç njiherë me të pa.
M'thuej pra lule, si kam me t'lanë me u tha ?

### 4. Tjetër

Nuk ma ka anda me m'rrëmby nji poezi tjeter
me u end me u endë nëpër hatulla metaforash
me groposë andrra që mbijnë nder déj e me u bá nji
me dëshirat e ngujume nëpër frikna
as me u deh e mos me njoftë gjakftoftësinë
në atë që quhet ndjenjë e n'varg me e lanë të lirë.
Varg pa mbrojtje kunder zgjimeve .
varg i minum me rrokje helmuese
ku pikat në fund të tij
lindin ndijime të verbëta
ashtu si vargu zinxhir me hallka
mëkati, imorali ...
Jo... asnji nga ata
sigurisht as nga këta;
skeletë narcistësh
si klloun ,veshun me petkun e mirësjelljes.
Me bojë në vend të gjakut ngjyrë
e unë derdhem në himne që trazojnë
shpirtin kur vullneti thyen vullnetin
sepse edhe kjo mund të jetë një tjetër.

### 5.Shkamb

Ti je atje ku dallgët terbohen me stuhi
të shfryejnë mllefin përplasen te ti
Ti je atje ku qielli rreket për shi
e retë e zeza të struken në gji.
Ti je atje ku zalli tek këmbët e tua
Gjen rehati ,aty ku nuk mbetesh kurrë në vetmi
Ti je atje me frymen e heshtjes
as plakesh ndër shekuj as mbetesh i ri,
turma e varre destinum me t'bá shoqni
Ti je atje kurrfeja s'të dëmton në pabesi
Atje ku ma s'i trembesh as fatit të bardhë
as fatit të zi.

### 6. Ndërgjegjësim

Ka njerëz që se meritojne as me i shá,
por me ja ledhatu ndergjegjen...
Si at' këmishen e bardhë, dikur e bardhe...
Tash të harrumen ,
lanun tutluç në raft
t'mykun ,
t'rrudhun
e gati të bame zhele.
Njollosë me danga vesesh
arna fajesh,
bamun nji me t'pafalshmen ...
Butësisht me ja marrë si s'parit ,
me e lá fatesh,
me e shplá mëkatesh
Me zbutë egon deri n'fëmini,
e me i than' :
Merre ! Ka me tu dashtë
me u dukë NJERI

### 7.Bije

Mjafton të rrëshqas shikimin
nga ftyra jote prej engjelli të bardhë
Në mes të errësinës je hanë e dëlire
Ajo bardhësi e freskët ,
zambak verbues
që kundërmon edhe poret e shpirtit
Ind i hollë i qerpikëve
mezi arrinë me fshehë
sytë e shëndritshëm
pasqyrë e mijëra botëve të fshehuna
E vështroj mes frikës e dashurisë
pa emen
zërat e natës së trishtë shuhen
Heshtja matet vetëm me frymemarrjen
ritmike të saj
Ajo buzeqeshje
si lule me perla
shkelqimi i lagesht ngyrëargjendi
mbi vese kristali...
E mu më dëbohet çdo ethe
çdo akull shkrinë
nga ngrohtësia e përqafimit
tand
bija jeme.....

### 8.Poezitë më bajnë me qeshë

Kur mendoj sa here i kam zymtu
ditët me të metat e kësaj bote
Sa herë m'ka rigu shpirti britma memece për t'pathanat e realitetit ,
Në nji kohë që realiteti me sheh mjerisht të katandisun mbas imazheve
Tjetersu n'kerkim t'vetevetes,
a të panjoftunes
Portret i nji mjeshtri , bojaxhi , murator , a skulptor ,
tu limu vargjet deri n'detaje
zhegut , nadjesh a naten vonë...
Herë - herë djall zhelaman
futë skutave të imagjinatës së frikshme që zbulon kodet e t'vërtetave imorale
Hah...! Sa e trishtë kur mjerisht kan'
qeshë edhe zogjt' tek i kam spikatë me vështrime demon-jake , se ata nuk ishin veç zogj ,
apo ,njikohësisht jam bá nji me to
Jam arratisë e kam marrë frymë
mes frymës tyne pa caqe
Jam derdhë ujnash pa u lá
Jam rrezu malesh pa u vrá
M'kanë dëgju pa britë
E m'kanë dasht' pa e ditë
Tash lexoj buzagaz
ndjenjat e marrëzisë
Njikohë , njiherë në nji vend ...

Opinioni i Ditës

# Shfaqja e panevojshme e Ramës në "Opinion"

Nga Andi Bushati

*(vijon nga faqja 1)*

... nuk ke nevojë.

Pikërisht këtë "urdhër" theu Edi Rama të enjten, me paraqitjen e tij në "Opinion". Ai doli përpara publikut për të rreshtuar një seri të pavërtetash të frikshme.

Gazetarët i nxorën përpara dokumentet zyrtare të prokurorisë, të pranuara edhe nga vetë Vangjush Dako, ku ai dëgjohet duke bashkëpunuar për grabitjen e votave me trafikantë droge, Rama tha se kjo është thjesht një "sallatë fjalësh". Ata insistuan se pse Prokuroria e Përgjithshme po e varros këtë dosje, Rama u përgjigj se Arta Markun nuk e ka zgjedhur ai. Ata i kërkuan se përse nuk reflektonte së paku politikisht me shkarkim, Rama tha se nuk bëhet politikë me përgjime. Ata këmbëngulën se ai pati bërë të njëjtën gjë me videon e Metës në 21 janar, Rama lëshoi një pasthirrmë të gjatë...



Por, ky nuk qe i vetmi episod, ku kryeministri u detyrua të gënjente rëndshëm.

Historia u përsërit edhe me shkrimin e tabloidit më të madh gjerman "Bild", që e etiketonte regjimin e tij si gangster dhe e implikonte vetë kryeministrin në përgjimet e dosjes '184'. Ai u rrek të bindte publikun shqiptar se shtypi gjerman qenkësh aq i paaftë, sa artikujt t'ia diktonin kundërshtarët e vet shqiptarë. Madje, shkoi edhe më tej. Kur iu përmend akuza e Blerina Gjylamentit se ky artikull ishte i blerë, ai u justifikua se ajo e kishte thënë këtë në kokë të vet.

Sikur të mos mjaftonin mashtrimet për Dakon, Arta Markun, përgjimet dhe "Bild"-in, ai i shtriu ato deri në Kosovë. Ai gënjeu edhe njëherë tjetër kur pretendoi se Ramush Haradinaj e kishte shpikur fabulën e presionit për heqjen e taksës. Megjithëse tashmë në shtyp kanë dalë edhe dëshmitarë të tjerë të kësaj ngjarjeje, ai këmbënguli me kokëfortësi në versionin e tij.

Natyrisht, askush nuk priste që Edi Rama të thoshte të vërtetën, qoftë edhe për një nga këto tema që do të kishte qenë e mjaft për të përligjur dorëheqjen e tij.

Ai nuk mund të pranonte as implikimin e trafikantëve në vjedhjen e zgjedhjeve, as akuzat e rënda të shtypit gjerman dhe as dyfytyrësinë epike që po tregon për Kosovën.

Por, është logjikisht e pakuptueshme se pse ai nuk iu përmbajt kodit të vjetër të mashtruesve: të mos gënjente pa pasur nevojë. Ta shmangte daljen në "Opinion" për të mos u përballur me ato pyetje që do ta nxirrnin zbuluar.

Në të gjitha vendet normale të rruzullit, nuk ka shef qeverie apo kryetar shteti që shfaqet në një intervistë aq të gjatë për të mos dhënë asnjë mesazh, për të mos përcjellë asnjë ide, për të mos shpalosur asnjë vizion për të ardhmen.

Rama bëri pikërisht këtë, hapin e panevojshëm të paraqitjes publike për të mashtruar. Dhe fatkeqësisht ky ves i doli dyfish në pah, tani që shpallja e paqes për mosdenigrimin e gazetarëve nuk e mbron dot si më parë.

**"Lapsi.al"**




## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje rekomandohen të shmangin altruizmin e tepërt, pasi kjo nuk do të pritet edhe aq mirë nga të tjerët. Rekomandohet të fokusoheni te familja dhe tek e ardhmja juaj. Ka gjasa të takoni një person me influencë, i cili mund t'ju ndihmojë në të ardhmen e afërt.

### DEMI

Një prej projekteve tuaja afatgjata do të rezultojë i suksesshëm. Tashmë ka ardhur koha t'i kushtoni më shumë rëndësi vetes. Nëse keni ndërmend të bëni blerje gjatë ditës së sotme, sigurohuni se po blini atë që dëshironi.

### BINJAKET

Ka gjasa që sot të jeni mjaft të ngarkuar me punët e shtëpisë, por edhe me familjarët që kërkojnë ndihmën tuaj. Kur të mbaroni së kryeri këto detyra, kalojeni pasditen ashtu sikurse ju dëshironi.

### GAFORJA

Kjo e diel mund të jetë shumë e qetë. Nëse dëshironi të ndiheni edhe më mirë, nisni të bëni plane për pushimet. Ndoshta ka ardhur momenti të realizoni udhëtimin e ëndrrave tuaja me partnerin ose me familjen.

### LUANI

Duhet të mbani një sekret sot dhe mos u tundoni ta zbuloni për asnjë arsye, pasi rrezikoni të prishni një surprizë. Nuk është dita e duhur për të eksperimentuar me stilin e veshjes. Përpiquni të gjeni kohën e duhur për t'u relaksuar.

### VIRGJERESHA

Do të reflektoni ndaj disa momenteve të sikletshme që keni kaluar disa kohë më parë. Megjithatë, përpiquni t'i kaloni këto momente dhe të ecni përpara. Flisni me një mik të ngushtë, nëse kjo ju bën të ndiheni më mirë.

### PESHORJA

Nëse keni kaluar një periudhë të vështirë, hiqni dorë nga gjërat që ju mërzisin dhe fokusohuni tek ajo që ju bën të ndiheni mirë. Bisedoni me partnerin për çdo problem dhe thojani gjërat hapur. Këtë pasdite bëni diçka që ju pëlqen, mund të shihni një film ose të shijoni natyrën.

### AKREPI

Sot do ta keni të vështirë t'u përmbaheni planeve, pasi mund të tundoheni nga një event, i cili ju premton shumë argëtim. Tregohuni të kujdesshëm, por ndjehuni të lirë për t'u përfshirë nëpër aventura apo sporte të ndryshme.

### SHIGJETARI

Nuk është dita e duhur për të kërkuar sqarime për një konflikt me një të afërmin tuaj. Duhet më shumë kohë për të arritur tek ai moment. Shpërfillni çdo presion që mund të ndjeni nga thashethemet rreth jush.

### BRICJAPI

Nëse ju ndodh një keqkuptim me partnerin/partneren mos u përpiqni ta zgjidhni menjëherë, pasi situata mund të përkeqësohet. Do të ishte më mirë nëse lini të kalojë pak kohë derisa gjërat të qetësohen.

### UJORI

Është dita e duhur për të bërë një lëvizje drejt një personi tek i cili i keni pasur sytë prej disa kohësh. Është e rëndësishme të tregoni durim, kujdes dhe takt për të arritur rezultatin që ju dëshironi.

### PESHQIT

Tregohuni të guximshëm dhe tentoni të provoni disa gjëra të reja sot. Mund të provoni një ushqim të ri, ose një stil të ri veshjeje. Rekomandohet të kaloni më shumë kohë me familjarët tuaj dhe merrni për bazë këshillat e tyre.

Opinioni *i* Ditës

# Të talentuarit

Nga Pëllumb Karameta

*(vijon nga faqja 1)*



... Si mund të identifikohen? Çfarë bëjnë të tjerët për t'i edukuar? Çfarë mund të bëhet më mirë për të talentuarit tanë?

A. Kuptimi i termit. Të përcaktosh një subjekt (fëmijë apo të ri) si të talentuar është e vështirë, sepse jo të gjithë e përcaktojnë në të njëjtën mënyrë "të talentuarin". Megjithatë, psikologët dhe edukatorët kanë hulumtuar gjatë viteve subjekte të talentuar, për të siguruar një profil të tipareve të tyre. Shumë studiues pranojnë se ky term identifikon subjektin që, fillimisht spikat për interesat që shpreh, ritmin me të cilin përparon, thellësinë e të kuptuarit, cilësinë e demonstrimit etj. Për të vijuar më pas me arritjet e tij, krahasuar me moshatarët, në fusha të tilla si shkenca, teknologjia, inxhinieria, matematika. Nëse dallimi është i dukshëm, mund të flitet për aftësi të theksuar ose për shumë të talentuar (p.sh., një 3-vjeçar mund të lexojë si një fëmijë në klasën e tretë ose një 9-vjeçar mund të luajë në piano si një 18-vjeçar, që ka studiuar vite me radhë). Sipas të dhënave statistikore, në grupin e shumë të talentuarve ose tejet të talentuarve bëjnë pjesë rreth 1% e subjekteve (janë ata që priret të bëhen nesër shkencëtarë dhe akademikë të shquar, gjyqtarë, parlamentarë dhe miliarderë). Të talentuarit, shpesh tërheqin vëmendjen që në shtëpi dhe më vonë, në shkollë, nëpërmjet rezultateve dhe sjelljeve. Ndërkaq, nuk është e lehtë t'i identifikosh, ngaqë ata, jo detyrimisht, kanë rezultate të larta në vijimësi. Sikundër, rezultatet mbi mesataren nuk mund t'i referohen doemos një të talentuari. Nga ana tjetër, meqë subjektet ndryshojnë në aftësitë dhe arritjet e tyre, një i tillë, që nuk shfaq talent në një fushë si matematika psh., mund të jetë i talentuar në një fushë tjetër, të themi muzika.

B. Identifikimi. Për të gjykuar rreth talentit të subjektit, përdoren teste të ndryshme nga psikologë me kualifikim të lartë, në qendra të specializuara. Një syresh është testi i koeficientit të inteligjencës (IQ), që shprehet nëpërmjet raportit të moshës mendore me moshën kronologjike. Shumica e njerëzve vendosen mes koeficienteve 85 dhe 115, me normë absolute 100. Në varësi të testit që përdoret, subjektet me aftësi të zhvilluara e kanë IQ nga 115 në 129; me talent të moderuar nga 130 në 144; shumë të talentuar nga 145 në 159; tejet të talentuar nga 160 në 179; me një talent të jashtëzakonshëm mbi 180.

Në vendet që marrin masa të posaçme për edukimin e të talentuarve, metoda mbizotëruese e përzgjedhjes zhvillohet nga testet me shkrim. Edhe pse testet standarde IQ janë mjeti më i zakonshëm i identifikimit të tyre, përdoren gjithashtu teste të tjera të inteligjencës dhe kreativitetit si testet "WISC-IV", testet "CogAT" etj., të cilat edhe psikologet tona shkollore besohet se i njohin. Testet ndryshojnë shumë në vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre, për moshat dhe kulturat e ndryshme, ndaj procedurat e identifikimit marrin parasysh një sërë sjelljesh që mund të jenë shenja të talentit.

Një ilustrim. Po sjellim rastin e një djali 12-vjeçar me emrin Xhozef Bejts (Joseph Bates) nga Baltimora - SHBA. Ai përparonte shumë më shpejt se shokët e klasës në matematikë, ndaj prindërit e regjistruan në një kurs vere kompjuteri. Duke qëndruar me studentë më të rritur në klasë, Xhozefi u mësoi atyre gjuhën e programimit FORTRAN. I pasigurt se çfarë duhet të bënte me djalin, instruktori i kompjuterit, në verën e vitit 1968, e prezantoi atë tek Julian Stanley, një studiues shumë i njohur në psikometri - studimi i performancës njohëse - në universitetin "J. Hopkins". Për të kuptuar më shumë për talentin e Xhozefit, studiuesi i dha atij një bateri testesh SAT që përdoreshin për pranimet e nxënësve 16 - 18-vjeçarë në kolegjet e SHBA. Rezultati i Xhozefit ishte shumë më i lartë se pragu i pranimit në atë universitet. Kjo bëri që Stanley të kërkonte një shkollë të mesme lokale, ku djali të merrte mësime të thelluara në matematikë dhe shkenca. Kur ky plan dështoi, studiuesi i bindi prindërit ta regjistronin Xhozefin në universitet. Kur filloi studimet, ai ishte 13 vjeç dhe i përfundoi ato në shkencat kompjuterike në moshën 17-vjeçare.

C. Edukimi i talenteve në botë. Programet për edukimin e të talentuarve hulumtojnë dhe zhvillojnë në mënyrë sistematike dhe strategjike potencialin e tyre. Subjekteve të talentuar u sigurohen mundësi për t'u arsimuar në nivele të përshtatshme, në mjedise mësimore fleksibël. Kështu psh., parimet udhëzuese për arsimin e të talentuarve në Hong Kong janë: a) identifikimi i të talentuarve të përfshijë gjerësinë e inteligjencës së shumëfishtë; b) të gjitha shkollat të kujdesen për të zhvilluar inteligjencën e shumëfishtë për të gjithë nxënësit; c) nevojat e të talentuarve të plotësohen më së miri në shkollat e tyre, duke ofruar mundësi sfiduese për ta; d) shkollat të njohin dhe përmbushin nevojat shoqërore, emocionale dhe intelektuale të fëmijëve të talentuar. Bazuar në këto parime orientuese, në vitin 2000 u miratua korniza e edukimit me tri nivele. Nivelet 1 dhe 2 sigurohen nga puna e shkollës, ndërsa niveli 3 është përgjegjësi e Akademisë. Niveli 1 u shërben të gjitha subjekteve të shkollës, pavarësisht aftësisë. Niveli 2 ofrohet për 2-10% të grupit (subjekte të afta), ndërsa niveli 3 ofrohet për 2% të grupit (subjekte të talentuara).

Sot në botë programet për edukimin e të talentuarve përfshijnë praktika, procedura dhe teori speciale. Qasjet kryesore për edukimin formal të tyre janë pasurimi, përshpejtimi dhe diferencimi. Një program pasurimi, për një lëndë ofron materiale shtesë, në kohën që subjekti ndjek të njëjtën klasë me bashkëmoshatarët. Psh., pasi ka përfunduar punën normale mësimore, programi i pasuruar i ofron detaje shtesë për lëndën. Ndërsa, një program përshpejtimi mundëson që subjekti pasi përfundon nxënien e një lënde brenda vitit mësimor, ndjek lëndën e klasës pasardhëse, edhe pse pjesa tjetër e klasës së tij ende punon në lëndën e parë. Ndërsa përshpejtimi radikal me dy ose më shumë vite është efektiv në aspektin akademik dhe shoqëror për shumë të talentuar. Hulumtimet sugjerojnë që përshpejtimi mund të ndikojë fort pas diplomimit nga shkolla e mesme. Shumica e të talentuarve përfitojnë nga një kombinim i qasjeve në kohë të ndryshme, përmes programeve të diferencimit. Procesi i nxënies, metodat dhe materialet përshtaten me nevojat e secilit nxënës dhe për shkakun që subjektet studiojnë me të tjerë të talentuar, secili është i motivuar të bëjë më të mirën. Fëmija që identifikohet me potencial të lartë njohës, pranohet në shkollë bazuar në moshën mendore dhe jo në moshën kronologjike.

Interesante, edhe përvoja e Singaporit. Çdo vit, atje 1% e subjekteve në vitin e tretë të shkollës fillore, sjellin në shtëpi një zarf të titulluar "Për shërbimin ndaj qeverisë". Brenda është një ftesë për pjesëmarrjen në programin e edukimit të fëmijëve të talentuar. Nëse prindërit pranojnë që fëmijët të përfshihen në një program të veçantë edukimi, ata testohen në matematikë, anglisht dhe "aftësi të përgjithshme". Singapori përdor teste të inteligjencës me pragje të rrepta për të identifikuar fëmijët me aftësi të lindura.

Në vende të tjera eksperimentohen dy mënyra kryesore pedagogjike. E para lidhet me mësuesit dhe psikologët që përdorin një gamë të gjerë metodash për të identifikuar fëmijët e talentuar, veçmas ata nga familjet e varfra. E dyta ka në fokus edukimin te fëmijët me aftësi të zhvilluara të tipareve të personalitetit të njerëzve të suksesshëm në një sërë disiplinash.

D. Të talentuarit tanë. Si t'i identifikojmë në vendin tonë subjektet me potencial të lartë për përsosmëri? Si mund të ushqehet ky potencial dhe të rriten gjasat që ata të ndikojnë dukshëm në sferat e shoqërisë sonë? Nisur nga gjendja, duket se përmirësimi kërkon ndryshime në kuadrin ligjor, përmes të cilave të rritet mbështetja institucionale (nga akademia, institucionet arsimore dhe rekrutimi i specialistëve ekselentë për zhvillimin/ofrimin e programeve speciale) dhe të përsosen kompetencat profesionale (të komunitetit të psikologëve, veças të psikologeve shkollore) dhe të mbështeten fort mësuesit e shquar) etj.

Sigurisht, nuk është e lehtë të gjesh qasje që funksionojnë për edukimin e të talentuarve, ca më e vështirë t'i zbatosh ato. Por, identifikimi i hershëm dhe edukimi special i të talentuarve tanë është burim i pashfrytëzuar, me potencial të madh për zhvillimin e shkencës, ekonomisë, artit dhe kulturës kombëtare. Ndaj, atë që nuk e dimë, mund ta mësojmë nga përvoja e vendeve që përparojnë në këtë aspekt. Ata ia dolën, pasi u investuan për edukimin e të talentuarve. Rikonceptuan bazat teorike dhe metodologjike të procesit të nxënies, reformuan kurrikulin dhe u dhanë jetë programeve speciale vetjake për nxënie, përmirësuan kompetencat profesionale të mësuesve/drejtuesve dhe sistemet e llogaridhënies. A mund të jetë ky një shteg për ndryshimin?

***Tiranë, më 17.05.2019***


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
MARKETING: 0688087323
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al